



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 230, datë 11.05.2023**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM  
GRADIMI, PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 2013-2016,  
GJATË USHTRIMIT TË DETYRËS SË INSPEKTORES  
PRANË INSPEKTORATIT TË ISH-KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 68, 89 e vijues dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (Gradimin) e gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së inspektores pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i hartuar nga relatores znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (Gradimin) e gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjatë ushtrimit të detyrës së inspektores pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, duke e vlerësuar atë, si më poshtë:
    - A. Aftësia profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
    - B. Aftësia organizative – “Shkëlqyeshëm”;
    - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
    - D. Aftësia personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
  2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSIA PROFESIONALE

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit në ish/Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të dokumentave të hartuar, vlerësuesi përqendrohet në të dhënat që përfshihen në dosjen me aktet e vlerësimit profesional të gjyqtarit, të dërguara nga organet e rivlerësimit kalimtar. Vlerësuesi çmon aftësinë hulumtuuese, interpretuese dhe logjikën e gjyqtarit në lidhje me hartimin e dokumentave ligjorë të tillë si: drafte aktesh nënligjore, projektvendime/vendime, opinione ligjore, analiza, materiale studimore krahasimore mbi kuadrin ligjor dhe jurisprudencial vendas dhe të huaj, projekt-raporte, raporte dhe materiale të tjera të lidhura me çështje specifike, etj. Aftësia profesionale e gjyqtarit të komanduar pikëzohet, sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.*

### 1.A. Njohuritë ligjore

*1.A.a Aftësia hulumtuuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave*

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} Osmanaj në ushtrimin e detyrës së inspektore së KLD-së identifikon qartë problematikën e çështjes, duke i kushtuar rëndësi këtij hapi të parë në proces. Ajo zotëron dhe shpreh një nivel mjaft të mirë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën duke i përditësuar këto njohuri në njohjen e pjesëve të reja të legjislacionit apo edhe vendimeve të reja unifikuese. Ngarkesa e lartë në punë nuk e ka penguar për të qenë krijuese në hartimin e raporteve apo në zhvillimin e drejtimeve të reja në këtë aspekt. Në 3 dokumentet e vëzhguara të kategorisë projektakte vlerësim gjyqtari, inspektorja {...} Osmanaj vlerëson këto aftësi sipas secilit*

kriter dhe grup kriter, identifikon problematikën e hasur në veprimtarinë e gjyqtarit, duke evidentuar në akt edhe mangësitë e konstatuara, nevojën për përmirësim të punës së gjyqtarit dhe në fund i propozon k/inspektorit vlerësimin etiko profesional të gjyqtarit për secilin grup kriter dhe në total atë përfundimtar. Rezulton se në të tre rastet e vlerësimit të gjyqtarit, propozimet nga Inspektorja {...} {...} janë miratuar pa ndryshime nga K/inspektorja dhe KLD (shih dokumentin nr.2, 6 dhe 7). Në 3 dokumentat ligjorë të kategorisë verifikim ankesash, identifikimi i shkakut të ankesës sipas problematikës së konstatuar pasqyrohet i plotë, i bazuar në faktet e verifikuara sipas procedurave të caktuara, të ballafaquara me shkakun ligjor dhe në pjesën e fundit të raportit si pjesë e titullar konkluzione, në çdo rast janë shoqëruar me propozimin përkatës për zgjidhjen e saj. Rezulton se në të tre rastet e verifikimit të ankesave, propozimet nga Inspektorja {...} {...} janë miratuar pa ndryshime nga Kryeinspektorja dhe zv/kryetari apo kryetari i KLD (shih dokumentin nr.2, 6 dhe 7). Në 2 dokumentat ligjorë të kategorisë përfaqësime të KLD në procese gjyqësore analiza ligjore realizohet në këndvështrim të dispozitave të K.Pr.Civile, K.Pr.Penale dhe K.Pr.Administrative, të ligjet organike për Organizmin e Pushtet Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të akteve ligjore dhe nënligjore të Inspektoratit të KLD, të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykatës Kushtetuese dhe dispozitave të tyre, të Gjykatës së Lartë dhe vendimeve unifikuese të saj, duke i cituar ato sipas rastit të plota apo të pjesshme edhe në fund të faqes”.

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të miratuar me vendimin e KLD-së nr. 81, datë 20.06.2016, për periudhën e vlerësimit 2013-2014, lidhur me aspektin e njohurive ligjore (nën titullin “Aftësitë profesionale teknike”, në treguesin “Aftësia për të përdorur njohuritë juridike”), konkludohet se: “Inspektorja {...} Osmanaj ka nivel shumë të mirë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën. Ajo tregohet shumë e kujdesshme për të marrë informacionin e nevojshëm për përditësimin e njohurive dhe për reflektimin e risive në praktikën e punës. Reflekton menjëherë në situatat e reja dhe pavarësisht ngarkesës së lartë të punës, përpiqet të jetë krijuese në hartimin e raporteve. Për pasojë, inspektorja {...} Osmanaj duhet të vlerësohet Shumë mirë për këtë aspekt”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

***- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit të komanduar për të shqyrtuar dhe përpunuar në mënyrë tërësore burimet me qëllim mbledhjen e informacioneve lidhur me çështjen e trajtuar***

Në drejtim të evidentimit dhe analizimit të aftësisë së gjyqtarës së komanduar për të shqyrtuar dhe përpunuar në mënyrë tërësorë të dhënat dhe informacionet lidhur me çështjen e trajtuar, dokumentet ligjore objekt vlerësimi ndahen në tre kategori :

- (i) relacione për verifikimin e ankesave;
- (ii) raporte konstatues për vlerësimin e gjyqtarit dhe
- (iii) përfaqësim në proces gjyqësor (parashtrime/prapësime të ish/KLD-së.

Referuar përmbajtjes së relacioneve për verifikimin e ankesave,<sup>1</sup> rezulton aftësia e gjyqtarës së komanduar në pozicionin e inspektores për të paraqitur në pjesën e parë të çdo relacioni: i) elementët që lidhen me paraqitjen e ankesës, ii) pretendimet thelbësore të ankuesit, iii) kalimin e saj për kryerjen e procedurës inspektorëve përkatës, si dhe iv) bazën ligjore të referuar në lidhje me kryerjen e verifikimit dhe hartimin e relacionit, çka i jep qartësi dokumentit në drejtim të përmbajtjes së tij dhe orientimit të saktë mbi objektin e verifikimit. Pas evidentimit të këtyre elementëve, në mënyrë koncize dhe të përmbledhur referohet përmbajtja e ankesës mbi bazën e të cilit është iniciuar verifikimi përkatës. Përmbajtja e ankesës paraqitet në mënyrë të përmbledhur duke u përqendruar në pretendimet konkrete të ankuesit, duke referuar edhe kohën dhe vendin e zhvillimit të fakteve të referuara, sipas ankesës fillestare të evidentimit të ngjarjes objekt verifikimi.

Referuar përmbajtjes së raporteve konstatues për vlerësimin e gjyqtarit,<sup>2</sup> rezulton aftësia e gjyqtarës së komanduar në pozicionin e inspektores për të evidentuar në pjesën e parë të çdo raporti konstatues elementët që lidhen me: i) periudhën e vlerësimit, ii) të dhënat personale të gjyqtarit, iii) dhoma apo seksioni ku ai ka ushtruar veprimtarinë gjatë periudhës së vlerësimit, iv) masat disiplinore të marra ndaj tij gjatë asaj periudhe. Pas evidentimit të këtyre elementëve, inspektorja përshkruan në mënyrë të detajuar të dhënat e realizuara nga verifikimet, konkretisht: a) të dhënat që dalin nga dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short, b) vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari, c) vendimet e cenuara nga gjykatat më e lartë, ç) çështjet e gjykuara tej afateve kohore, d) rezultatet e verifikimit të ankesave, dh) vlerësimin e kryetarit të gjykatës dhe në përfundim paraqet analizën e gjetjeve nga verifikimi i dosjeve gjyqësore.

Në dokumentat ligjorë për përfaqësime në procese gjyqësore (parashtrime),<sup>3</sup> gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektores, pasqyron në pjesën hyrëse palët ndërgjyqëse të çështjes gjyqësore për të cilën janë përgatitur parashtrimet përkatëse, duke vijuar me evidentimin e pretendimet thelbësor të ankuesit/kërkues të parashtruar në ankim/kërkesë. Pas evidentimit të këtyre elementëve, në nënndarjen “Mbi faktet” përshkruhen në mënyrë të përmbledhur faktet e çështjes objekt kundërshtimi, si dhe duke referuar në çdo rast në provat përkatëse mbi të cilat ato kanë rezultuar. Faktet e çështjes paraqiten në mënyrë të përmbledhur duke u përqendruar në elementët thelbësorë të vendimmarrjes së KLD-së, objekt kundërshtimi në gjykatë, pa u ndalur në elementë të tjerë, të cilët nuk kanë rëndësi për gjykimin.

Në drejtim të evidentimit dhe analizës tërësore të burimeve të të dhënave dhe informacioneve lidhur me çështjen e trajtuar, nga përmbajtja e relacioneve për verifikimin/trajtimin e ankesave, rezulton se ato evidentohen dhe analizohen në mënyrë të qartë dhe të saktë, duke referuar në dokumentet apo të dhënat konkrete të marra gjatë

<sup>1</sup>Relacioni i datës 20.11.2013 që lidhet me verifikimin e ankesës për gjyqtarin F.V; Relacioni i datës 28.04.2014 që lidhet me verifikimin e ankesës për gjyqtaren M.R dhe relacioni i datës 02.04.2014 që lidhet me verifikimin e ankesës për gjyqtaren Dh.B.

<sup>2</sup>Raporti konstatues për vlerësimin e gjyqtarit Q.Z.; Raporti konstatues për vlerësimin e gjyqtarit L.L dhe Raporti konstatues për vlerësimin e gjyqtarit M.P.

<sup>3</sup>Parashtrime të KLD-së para Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen me kërkues N.T. dhe parashtrime të KLD-së para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me çështjen me ankuese E.Gj.

procedurës së verifikimit, si pjesë e nënndarjes “Rrethanat e çështjes”, ku gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore referon faktet, i analizon ato dhe më pas i vlerëson në mënyrë të veçantë, në lidhje me çdo pretendim apo çdo aspekt të vlerësuar me vend dhe brenda objektit të verifikimit të kryer.

E njëjta shkallë kujdesi evidentohet edhe në shqyrtimin dhe përpunimin e të gjitha burimeve fizike të nevojshme për vlerësimin e gjyqtarëve (të dhëna statistikore, vendime gjyqësore, dosje gjyqësore...etj). Mbledhja e të dhënave të nevojshme për vlerësim rezultojnë plotë, e strukturuar saktë në raport sipas përmbajtjes së tyre, në përputhje me secilin kriter vlerësimi. Gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore tregon kujdes në ndarjen e pasqyrimin në raportet konstatues, të të dhënave burimore nga analiza e tyre.

***- Në lidhje me përcaktimin e elementeve faktikë të çështjes për trajtim***

Në dokumentet ligjore burim vlerësimi faktet e çështjes janë renditur kryesisht në pjesën e dytë të relacionit/parashtrimeve me nën titullin “Rrethanat e çështjes” ose “Mbi faktet”, duke u përshkruar në mënyrë të plotë, të qartë dhe koncize. Të dhënat mbi faktet e çështjes në çdo rast i referohen dokumenteve dhe informacioneve të marra në kuadër të procedurës së verifikimit, apo vendimmarrjes së ish/KLD-së objekt kundërshtim, duke referuar drejtpërdrejt në përmbajtjen e tyre dhe duke ekstraktuar prej tyre faktin konkret, që paraqet rëndësi për trajtimin e ankesës/çështjes. Në këtë mënyrë, në çdo rast paraqitja e rrethanave të faktit ndërthuret në mënyrë logjike me të dhënat që rezultojnë nga dokumentet dhe informacionet e administruara, mbi bazën e së cilave fakti objekt verifikimi/kundërshtimi është ndërtuar dhe më pas i është nënshtruar analizës dhe vlerësimit/konkluzionit nga inspektori.

Në raportet konstatues për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit, elementët faktike mbi të cilët analizohen gjetjet e inspektorit, paraqiten dhe analizohen me vete dhe të integruar me njëri tjetrin, duke ekstraktuar prej tyre të dhënat konkrete mbi të cilat bazohet propozimi për nivelin e vlerësimit të gjyqtarit.

Rezultoni dukshme aftësia e gjyqtarës së komanduar në pozicionin e inspektore për t'i përmbledhur dhe parashtruar faktet e çështjes në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke evidentuar elementet thelbësore që lidhen me objektin e verifikimit, atë të vlerësimit etik dhe profesional apo parashtrimeve para gjykatës, pa u ndaluar në elementë periferikë të faktit objekt trajtimi.

***- Në lidhje me identifikimin e natyrës së çështjes për trajtim***

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, natyra e çështjes konsiston në përcaktimin saktësisht të :

- i) objektit të verifikimit/inspektimit, i cili evidentohet qartë dhe në mënyrë të shprehur duke iu referuar pretendimeve të ngritura në materialin me të cilin është iniciuar verifikimi, pa u ndalur në elementë periferikë dhe jo të qenësishëm që mund të përmbajë ankesa përkatëse. Rezulton e dukshme aftësia e gjyqtarës së komanduar në pozicionin e inspektores që, pas studimit të rastit, të përcaktojë qartë dhe në mënyrë të shprehur objektivin/at konkrete dhe thelbësore të verifikimit, pavarësisht mënyrë së parashtrimit të tyre nga subjektet ankuuese/referuese në çështjen konkrete;
- ii) qëllimit dhe natyrës që ka vlerësimi etik dhe profesional i gjyqtarëve e përpilimi i raporteve konstatues të vlerësimit, ku evidentohet qartë dhe në mënyrë të shprehur autoriteti i ish/Inspektoratit të KLD si i vetmi autoritet përgjegjës për vlerësimin e gjyqtarëve, duke referuar edhe bazën ligjore përkatëse;
- iii) natyrës së gjykimit administrativ të akteve të ish/KLD-së, objekt kundërshtimi në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e natyrën e gjykimit kushtetues ndaj masave disiplinore « shkarkim nga detyra » (dokumentet ligjorë për përfaqësime në proces gjyqësore).

**- *Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm dhe/ose konfliktit të normave***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes lidhet edhe me identifikimin e normave të akteve ligjore apo nënligjore të zbatueshme në drejtim të analizës mbi çështjen konkrete. Në këtë drejtim, referuar dokumenteve ligjore burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektores, në çdo rast ka identifikuar dhe referuar ligjin e zbatueshëm, si pjesë integrale e analizës së saj mbi çështjen, dhe konkretisht:

- Identifikon si ligj të zbatueshëm dispozita të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (nenin 16) dhe Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD” (nenin 31) që përcaktojnë detyrat e inspektorit dhe mënyrën e inspektimit/verifikimit të ankesave. Kjo bazë ligjore identifikohet në çdo rast në pjesën hyrëse të relacioneve.<sup>4</sup>
- Referon nenet 4 dhe 23 të Kodit të Etikës Gjyqësore, nenin 24 pika 1, shkronja c) “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së” në lidhje me përcaktimin e objektit të verifikimit të ankesës në drejtim të etikës së gjyqtarit;<sup>5</sup>
- Referon nenin 176 të K.Pr.Civile lidhur me shkaqet e arsyeshme për shtyrjen e seancës gjyqësore, në kuadër të verifikimit të pretendimeve për zvarritje të gjykimit;<sup>6</sup>
- Referon nenin 181 të K.Pr.Civile lidhur me rifillimin nga e para të gjykimit të çështjes civile si pasojë e ndryshimit të trupit gjykues, nenin 158/a të K.Pr.Civile lidhur me kryerjen e veprimeve përgatitore dhe nenin 185 të K.Pr.Civile në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës mbi kërkesën për saktësimin e objektit të padisë. Në lidhje me shkeljet procedurale të pretenduara për mos arsyetimin e vendimit brenda afateve ligjore, referon nenin 308 të K.Pr.Civile;<sup>7</sup>

<sup>4</sup>Në të tre dokumentat ligjore që konsistojnë në objekt verifikimi/inspektimi

<sup>5</sup>Relacioni i datës 20.11.2013, “Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtarin F.V.”

<sup>6</sup>Po aty

<sup>7</sup>Relacioni i datës 02.04.2014, “Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtaren DH.B.”

- Referon nenin 460/2 të K.Pr.Civile në lidhje me kompetencat e kryetarit të gjykatës së apelit për vënien në lëvizje e çështjeve civile duke caktuar seancën e parë gjyqësore, në funksion të verifikimit të pretendimeve të ankuesit për zvarritjen e gjykimit;<sup>8</sup>
- Në raportet konstatuese për vlerësim gjyqtari, gjatë analizës së gjetjeve në drejtim të aftësisë së gjyqtarit për të planifikuar dhe organizuar procesin gjyqësor, gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore, referon nenet 333 dhe 342/2 të K.Pr.Penale në lidhje me afatet procedurale për caktimin dhe planifikimin e seancave gjyqësore. Po kështu, në drejtim të vlerësimit të aftësisë së gjyqtarit për qartësinë e të shkruarit në vendim, referon nenet 310 të K.Pr.Civile dhe 383 të K.Pr.Penale në lidhje me elementet e domosdoshëm të vendimit përfundimtar.<sup>9</sup>
- Referon nenin 147/6 të Kushtetutës dhe nenin 32 pika 2 shkronja b) të ligjit 9877, datë 18.02.2008 “Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me ushtrimin e kompetencës kushtetuese të KLD në vendimmarrjen për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.<sup>10</sup> Në funksion të argumentimit se pretendimi i gjyqtarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe parimit të gjësë së gjykuar gjatë procedimit disiplinor nuk qëndron, gjyqtarja e komanduar në detyrën e inspektore referon dhe citon nenin 35 të ligjit 9877/2008 dhe nenin 2/a të “Rregullores për procedimin disiplinor të gjyqtarëve”, lidhur me të drejtat e gjyqtarit në një procedim disiplinor.<sup>11</sup>
- Referon dhe citon nenin 32 pika 2 shkronja “b” dhe “e” të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, në lidhje me shkeljet disiplinore të gjyqtarit dhe posaçërisht ato që lidhen me sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit në rastin e braktisjes së punës e mungesën e pajustificuar dhe të vazhdueshme për 7 ditë, si dhe në rastin e mungesës absolute të arsyetimit të vendimit gjyqësor.<sup>12</sup>
- Në mbështetje të argumentimit se pretendimi i ankuesit për mos marrjen dijeni efektivisht për procesin administrativ të zhvilluar në ngarkim të tij nuk qëndron, gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore, referon nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me procesin e rregull ligjor. Po për këtë qëllim referon në vendimet e Gjykatës Kushtetuese me nr.5/2013, nr.26/2012, nr.26/2012, nr.45/2011, nr.30/2012 dhe nr.35/2013, lidhur me rregullshmërinë e procesit penal, në kushtet kur procedura objekt shqyrtimi është një procedurë administrative e ngjashme me procesin penal dhe mund të aplikohet “*mutatis mutandis*”. Referon rezolutën e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës (75)11 “Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit”, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 28.02.2000, nr.25, datë 28.10.2005, nr.40, datë 22.09.2011 lidhur me qëndrimin e se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin e parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese. Referon vendimin nr. 15/2011 të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me konkurrimin e përgjegjësisë penale me përgjegjësinë administrative.<sup>13</sup>

<sup>8</sup>Relacioni i datës 28.04.2014 “Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtaren M.R.”

<sup>9</sup>Raportet konstatuese për vlerësimin e gjyqtarëve M.P. dhe L.L.

<sup>10</sup>Këto dispozita referohen edhe në parashtrimet e KLD-së para Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen me kërkues N.T

<sup>11</sup>Parashtrime të KLD-së para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me çështjen me ankuese E.Gj

<sup>12</sup>Po aty

<sup>13</sup>Parashtrime të KLD-së para Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen me kërkues N.T



- Identifikon dhe referon nenin 6/1 të KEDNJ lidhur me detyrimin e gjykatës për të arsyetuar vendimet e tyre. Po ashtu, ka referuar edhe praktikën e GJEDNJ në lidhje me këtë aspekt duke referuar qëndrimin e mbajtur në çështjen “*Hadjianastassiou kundër Greqisë*” apo në çështjen “*Hirisaari kundër Finlandës*”. Lidhur me standardet për vlerësimin e një vendimi gjyqësor si të arsyetuar referohen vendimet nr.20, datë 13.04.2012 dhe nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese.<sup>14</sup>
- Referon nenin 2 të K.Pr.Penale dhe nenin 1 të K.Pr.Civile lidhur me karakterin detyrues të normave procedural penale dhe civile, në funksion të argumentimit se afatet e përcaktuar në nenet 308 të K.Pr.Civile dhe 113 të K.Pr.Penale për arsyetimin e vendimit, janë dispozita urdhëruese që detyrojnë gjyqtarin të arsyetojë vendimin brenda afatit të caktuar. Identifikon dhe referon nenin 13 të K.Pr.Civile lidhur me fakte të njohur botërisht që nuk kanë nevojë të provohen.<sup>15</sup>

***Sa i përket konfliktit të normave***, në dokumentet ligjore burim vlerësimi nuk rezultojnë të jetë evidentuar apo të ketë qenë e nevojshme analiza mbi konfliktin mes normave ligjore të zbatueshme.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektores pranë ish/Inspektoratit të KLD-së, ka aftësi shumë të mira për identifikimin tepër të qartë, konciz, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes/ankesës objekt shqyrtimi, paraqitjen e tyre në mënyrë të integruar me të dhënat/faktet që rezultojnë nga dokumentacioni dhe informacioni i marrë për efekte të verifikimit të ankesës, pasqyrimin e veprimeve procedurale të kryera gjatë procedurës së verifikimit, duke integruar në përmbajtje të fakteve dhe pjesë të dokumenteve apo informacioneve me shkrim të marra (*deklarimet e gjyqtarit subjekt verifikimi, pjesë nga vendimet gjyqësore të shqyrtuara, etj.*). Gjithashtu, rezultojnë aftësia e gjyqtarës së komanduar në pozicionin e inspektores për grumbullimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të nevojshme të marra nga burimet e vlerësimit për qëllime të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtareve, në përputhje me kriteret e caktuara në ligj dhe rregulloren “Mbi sistemin e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve”. Sa i përket identifikimit të normës/normave të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim, në të gjitha dokumentet burim vlerësimi referohen dispozita të ligjit dhe akteve nënligjore të KLD-së lidhur me procedurën e verifikimit/ inspektimit dhe baza ligjore në mbështetje të mendimit të inspektorit mbi mënyrën e përfundimit të trajtimit të ankesës. Po ashtu, identifikohen dispozita të ligjit procedural penal ose civil, dispozita të ligjeve organike, etj., të cilat mbështesin argumentimin ligjor të inspektores lidhur me gjetjet në raportet konstatues të vlerësimit etik dhe profesional. Përbën vlerë të shtuar, identifikimi dhe referimi në mbështetje të arsyetimit ligjor, i praktikës së GJEDNJ dhe Gjykatës Kushtetuese lidhur me

---

<sup>14</sup>Po aty

<sup>15</sup>Po aty

aspekte të ndryshme të procesit të rregullt ligjor, etj., të cilat aplikohen në drejtim të standardeve objekt vlerësimi për rastet e trajtuara.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësitë hulumtuese për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Në 2 dokumentat ligjorë të kategorisë përfaqësime të KLD në procese gjyqësore, analiza ligjore realizohet në këndvështrim të dispozitave të K.Pr.Civile, K.Pr.Penale dhe K.Pr.Administrative, të ligjet organike për Organizmin e Pushtet Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të akteve ligjore dhe nënligjore të Inspektoratit të KLD, të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykatës Kushtetuese dhe dispozitave të tyre, të Gjykatës së Lartë dhe vendimeve unifikuese të saj, duke i cituar ato sipas rastit të plota apo të pjesshme edhe në fund të faqes. Në këto dokumente inspektorja {...} Osmanaj evidenton njohuritë e saj ligjore mjaft të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural, parimet themelore në fushat e së drejtës administrative, të drejtës civile, të drejtës penale duke cituar sipas rastit edhe termat latinë si: parimin e një procesi të rregullt ligjor, parimin e barazisë së armëve, parimin e kontradiktoritetit, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e subsidiaritetit (shih dokumenti 3), parimin e gjësë së gjykuar dhe parimin e sigurisë juridike (shih dokumenti 8). Ajo analizon edhe doktrinën e llojit të përgjegjësive të funksionarit publik dhe evidenton rastet kur përgjegjësia administrative konkurron me përgjegjësinë penale (shih dokumentin nr.3). Rezulton se në të dy rastet e përfaqësimit të KLD-së nga inspektorja {...} {...}, vendimi i gjykatës ka qenë në favor të KLD (shih dokumentin nr.3 dh 8)”.

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, nëpërmjet këtij treguesi vlerësohet aftësia e gjyqtarit të komanduar për të interpretuar ligjin e identifikuar, arsyetimi për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi çështjet e shtruara për trajtim, pasqyrimi dhe/ose analizimi i të dhënave në zbatim dhe në përputhje me ligjin e identifikuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, aftësia për të evidentuar dhe/ose zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit, si dhe, për aq sa është e mundur aftësia e tij për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante, në mbështetje të interpretimit.

Në pikën 3, shkronja f) të nenit 31 të Vendimit të KLD-së me nr.195/2/a, datë 05.07.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”, lidhur me përmbajtjen e raportit për verifikimin e ankesave parashikohet se dokumenti në lidhje me verifikimin e ankesës, ndër të tjera, duhet të përmbajë edhe përfundimet e arsyetuara që dalin lidhur me ekzistencën në rastin konkret të shkeljeve të ligjit, si dhe tërheqja e konkluzioneve të arsyetuara nëse ato shkelje të lejuara përbëjnë shkelje të disiplinës në kuptim të ligjit. Në lidhje me raportet e kryera në kuadër të vlerësimit të gjyqtarëve, në nenin 27 të Vendimit të KLD-së me nr.261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, parashikohet se *“Në raportin konstatues, përshkruhen: periudha e vlerësimit; të dhënat personale të gjyqtarit; dhoma apo seksioni ku ai ka ushtruar veprimtarinë gjatë periudhës së vlerësimit; masat disiplinore të marra ndaj tij gjatë asaj periudhe si dhe pasqyron në mënyrë të detajuar të dhënat e rezultuara nga verifikimet sipas nenit 23, pika 1 të sistemit. Në përfundim, inspektori bën propozimin për vlerësimin e gjyqtarit duke iu referuar secilit grup të kriterëve të vlerësimit”*.

Sa më sipër rezulton se, dokumentet e hartuara nga inspektori në kuadër të veprimtarisë profesionale të tij, në rastet e verifikimit të ankesave apo inspektimit, përveç përshkrimit dhe analizës së fakteve dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm, duhet të përmbajnë argumente mbi interpretimin dhe zbatimin e tij mbi rastin konkret. Po kështu, edhe në rastet e vlerësimit të gjyqtarëve, përveç përshkrimit në mënyrë të detajuar të të dhënave të rezultuara nga burimet e vlerësimit, inspektori duhet të analizojë dhe të nxjerrë përfundimet sipas kriterëve matëse në kontekstin e duhur. Interpretimi i ligjit të zbatueshëm në funksion të mbështetjes të analizës së rastit dhe rekomandimeve mbi mënyrën e përfundimit të tij, apo në mbështetje të përfundimeve të vlerësimit të gjyqtarit, paraqet rëndësi me qëllim përmbushjen në mënyrë cilësore të funksionit të inspektorit në lidhje me trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes konkrete apo vlerësimin për aftësinë profesionale dhe etike të gjyqtarit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

***- Në lidhje me aftësinë për të interpretuar ligjin e identifikuar për zgjidhjen e çështjes për trajtim dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi çështjen konkrete***

Në dokumentet ligjore burim vlerësimi, normat e ligjit procedural civil ose penal sipas rastit të verifikuar, si dhe normat e ligjit organik që përcakton shkeljet disiplinore të gjyqtarëve,

janë shoqëruar, përpos identifikimit të tyre, me interpretim dhe më pas me dhënien e arsyeve mbi mënyrën e aplikimit mbi faktet e çështjes konkrete, por në nivele të ndryshme arsyetimi në varësi të kompleksiteti apo natyrës (verifikim ankese/vlerësim/ përfaqësim gjyqësor) të rastit në shqyrtim.

Kështu, në dokumentet ligjore që lidhen me verifikimin e ankesave, situatat faktike të marra në shqyrtim paraqiten jo komplekse, normat relevante për zgjidhjen e çështjes identifikohen dhe, sipas rastit aplikohen drejtpërdrejt, ose interpretohen në mënyrë të shkurtuar, dhe më pas aplikohen mbi faktin konkret, në shërbim të konkluzionit të arritur nga inspektorja në mbështetje të opinionit të saj mbi zgjidhjen e çështjes. Po ashtu, edhe normat me karakter procedural që lidhen me procedurën e verifikimit apo sugjerimin mbi mënyrën e përfundimit të tij, referohen dhe aplikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktin konkret. Konkretisht:

- Në relacionin e datës 02.04.2014 inspektorja analizon shkaqet që ndikojnë në kohëzgjatjen e procesit gjyqësor, referon dhe interpreton nenin 181 të K.Pr.Civile lidhur me nisjen nga fillimi të procesit gjyqësor si pasojë e ndryshimit të trupit gjykues; referon dhe interpreton nenin 158/a të K.Pr.Civile në funksion të evidentimit se në kohëzgjatjen e procesit gjyqësor ka ndikuar edhe kryerja e veprimeve përgatitore. Po ashtu, në këtë akt inspektorja referon dhe interpreton nenin 185 të K.Pr.Civile në funksion të konkluzionit të saj se shtyrja e seancës për njoftimin e kërkesës për saktësimin e objektit të padisë përbën shkak të përligjur.
- Në relacionin e datës 28.04.2014, referon dhe interpreton nenin 460/2 të K.Pr.Civile në lidhje me kompetencën e kryetari të gjykatës së apeli për të vënë në lëvizje çështjen civile, në funksion të përcaktimit të përgjegjësisë në lidhje me vënien në lëvizje dhe vonesat në zvarritjen e gjykimit, për të cilën gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore ka sugjeruar edhe kryerjen e një inspektimi në lidhje me mënyrë e vënies në lëvizje të dosjeve nga gjykatat e apeli dhe nxjerrjen e një rekomandimi për unifikimin e praktikave të ndryshme.

Në rastet me karakter kompleks, kur objekt kundërshtimi kanë qenë vendimmarrjet e KLD, referuar pretendimeve të ngritura nga ankuesi/kërkuesi përpara Gjykatës së Lartë apo Gjykatës Kushtetuese, inspektorja i ka kushtuar rëndësi të dukshme jo vetëm referimit dhe mënyrës së aplikimit të normave të akteve ligjore ose nënligjore, por edhe interpretimit teorik të tyre, para aplikimit mbi faktin. Në këto raste ky interpretim është mbështetur edhe me qëndrime të praktikës gjyqësore (*vendime të GJEDNJ dhe GJK*) duke pasuruar interpretimin e normës së bërë prej saj, para argumentimit mbi aplikimin e saj mbi faktin konkret. Kështu, në mënyrë specifike, evidentohet se:

- Në parashtrimet e ish/KLD para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me çështjen me ankues E.GJ., me objekt kundërshtimi i vendimit për miratimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, inspektorja fillimisht është ndalur tek kompetenca kushtetuese e KLD-së për të shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit, duke interpretuar për këtë qëllim nenin 147/6 të Kushtetutës dhe nenin 32/2 shkronja "b" të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizmin e pushtetit

gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Në funksion të argumentimit se pretendimet e ngritura nga ankuesi se gjatë procedimit disiplinor është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe parimi i gjësë së gjykuar nuk qëndrojnë, inspektorja referon dhe interpreton nenin 35 të ligjit 9877, datë 18.02.2008 dhe nenin 2/a të vendimit të KLD-së nr.173, datë 21.02.2003 “Rregullore për procedimin disiplinor të gjyqtarit”, si dispozita ku mishërohen këto parime, nëpërmjet pasqyrimin në mënyrë të detajuar të të drejtave të gjyqtarit gjatë procedimit disiplinor. Po kështu, lidhur me pretendimin e ankuesit se mos arsyetimi i vendimit nuk përbën shkelje për përgjegjësi disiplinore, gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore interpreton nenin 32 pika 2 shkronja “e” të ligjit 9877, datë 18.02.2008 për të konkluduar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është aspekt i procesit të rregullt ligjor. Po për këtë qëllim, inspektorja ka referuar dhe në standardet e përcaktuara në nenin 6 të KEDNJ. Po në funksion të argumenteve se mungesa e pajustificuara të gjyqtarit në detyrë përben shkelje shumë të rëndë disiplinore referon dhe interpreton nenin 32 shkronja “b” të ligjit 9877/2008.

- Në parashtrimet e KLD para Gjykatës Kushtetuese, lidhur me çështjen me ankues N.T., me objekt shfuqizimin e vendimit për shkarkimin nga detyra, pas referimit dhe interpretimit të nenit 147/6 të Kushtetuese dhe nenit 32/2 shkronja “c” të ligjit 9877/2008 lidhur me kompetencën e KLD për dhënien e masës së shkarkimit nga detyra të gjyqtarit në rastet e shkeljeve shumë të rënda që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, inspektorja ka vijuar me argumentet e saj lidhur me pretendimet e ngritura nga kërkuesi. Kështu, lidhur me pretendimin për mosmarrjen dijeni efektivisht për procesin administrativ, inspektorja ka referuar dhe interpretuar nenin 42 të Kushtetuese dhe nenin 6 të KEDNJ. Interpretimin e saj lidhur me të drejtën për t’u njoftuar, për të marrë pjesë në procedim, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, si aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, e mbështet edhe në qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimet me nr.5/2013, nr.26/2012, 45/2011, nr.30/2012 dhe nr.35/2013. Po për këtë qëllim, inspektorja ka referuar edhe rregullat e vendosura për të pandehurin në mungesë në Rezolutën (75) 11 të Komiteti të Ministrave të Këshillit të Europës.
- Po në këtë rast, lidhur me të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar si një aspekt i procesit të rregullt ligjor, inspektorja referon standardet e përcaktuara në nenin 6 të KEDNJ, duke e pasuruar edhe me qëndrimin e GJEDNJ në çështjen “*Hadjianastassiou kundër Greqisë*”, me datë 16.12.1992 dhe çështjen “*Hirvisaari kundër Finlandës*”, me datë 27.09.2001. Në funksion të argumentimit se pretendimi i kërkuesit se faktet e konstatuar nuk përbëjnë shkelje disiplinore nuk qëndrojnë, inspektorja ka referuar nenin 32/2/c të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”, në lidhje me shkeljet disiplinore të gjyqtarit dhe më tej ka interpretuar dispozitën përkatëse në funksion të përcaktimit të kushteve që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative në mënyrë që rasti i shkeljes së pajustificuar e të përsëritur të dispozitave urdhëruese procedurale të konsiderohet se ka diskredituar shumë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.
- Në çdo raport konstatues për vlerësimin e gjyqtarit (3 të tillë), interpretohen dispozita të Vendimit nr.261/2 dt. 14.04.2010 të ish/KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, në lidhje me atë se çfarë vlerësohet për secilin nga tre kriteret e vlerësimit : Grupi i aftësive profesionale të përgjithshme, organizuese dhe zbatuese; Grupi i aftësive profesionale

juridike dhe teknike dhe Grupi i kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional. Pavarësisht se nuk citohet shprehimisht dispozita përkatëse, gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektorit përcakton nëpërmjet interpretimit saktësisht që në fillim të analizës së gjetjeve nga verifikimi i dosjeve gjyqësore, atë se çfarë vlerësohet për secilin indikator vlerësimi të secilit grup kriteri, para se të bëjë analizën e të dhënave burimore përkatëse. Kjo mënyrë e standardizuar analize i shërben metodologjisë së ndërtimit të saktë dhe të kuptueshëm të analizës së gjetjeve për çdo tregues vlerësimi. Nga ana tjetër, përcaktimi nëpërmjet interpretimit saktësisht të asaj se çfarë vlerësohet për çdo grup treguesish të një kriteri, i jep kuptim arsytimit për mënyrën e zbatimit të aktit nënligjor mbi të dhënat burimore të marra.

**- Në lidhje me aftësinë për të evidentuar dhe/ose aplikuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale dhe aftësinë për të referuar jurisprudencës relevante**

Në dokumentet burim vlerësimi, sikurse është evidentuar edhe më sipër në këtë raport, rezulton kujdesi i gjyqtarës së komanduar në pozicionin e inspektore për t'iu referuar parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe për të mbështetur argumentet e saj mbi mënyrën e aplikimit dhe interpretimit të ligjit, në jurisprudencën relevante, duke i dhënë vlerë të shtuar dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Konkretisht, evidentohet se ajo referon:

- Referon *parimin e ligjshmërisë*, edhe pse nuk e evidenton atë shprehimisht, por rezulton qartë nga konteksti edhe arsytimi i saj lidhur me elementë të kompetencës së organit si një ndër elementët e këtij parimi. Kështu kujdeset të evidentojnë dhe referojë dispozitat që përcaktojnë kompetencën e organit për kryerjen e inspektimit në çdo akt burim vlerësimi.<sup>16</sup> Po ashtu, ky parim evokohet edhe në rastin e parashtrimeve në proceset gjyqësore lidhur me kompetencën e KLD për shkarkimin e gjyqtarit, si dhe në rastin e vlerësimeve ku evidentohet kompetenca e Inspektoratit të KLD si autoritet i vetëm përgjegjës për kryerjen e vlerësimit etiko profesional të gjyqtarit.
- Referon dhe merr në analizë të thelluar *parimin e procesit të rregullt ligjor* duke analizuar aspekte të procesit të rregullt ligjor, në raport me pretendimet e ngritura nga ankuesi/kërkuesi kundër vendimmarrjes së KLD, duke u ndalur në aspekte të tilla si *e drejta për tu njoftuar, për të marrë pjesë në procedim, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*,<sup>17</sup> *parimi i prezumimit të pafajësisë*,<sup>18</sup> *standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*,<sup>19</sup> etj. Referon *parimin e subsidiaritetit*, i cili konsiston në ndarjen e funksioneve në procedimin administrativ, midis niveleve të ndryshme qeverisëse, duke marrë në konsideratë faktin e moscenimit të parimit kushtetues të pavarësisë së pushteteve dhe marrëdhënieve kontroll dhe balancë ndërmjet tyre. Ky parim analizohet nga inspektorja në të dy aspektet e tij, horizontal dhe atë vertikal.

<sup>16</sup>Relacioni i datës 20.11.2013 “Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtarin F.V”; .Relacioni i datës 28.04.2014 “Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtaren M.R.” dhe Relacioni i datës 02.04.2014 “Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtaren Dh.B.”

<sup>17</sup>Parashtrime të KLD-së para Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen me kërkues N.T

<sup>18</sup>Po aty

<sup>19</sup>Parashtrime të KLD-së para Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen me kërkues N.T. dhe parashtrime të KLD-së para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me çështjen me ankuese E.Gj.

- Referon dhe merr në analizë *parimin e sigurisë juridike* dhe *parimin e gjësë së gjykuar “ne bis in idem”*, si ndër parimet kryesore që qëndrojnë në themel të procedimit disiplinor të gjyqtarëve.<sup>20</sup>

Sa i përket identifikimit dhe referimit në jurisprudencën relevante, rezulton se referon:

- Vendimin e GJEDNJ në çështjen *“Hadjianastassiou kundër Greqisë”*, *“Hirvisaari kundër Finlandës”* dhe *“Ruiz Torija kundër Spanjës”* në lidhje me standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar;<sup>21</sup>
- Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 13.04.2012 dhe nr.38, datë 30.12.2010 po në lidhje me standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar; Vendimin e Gjykatës Kushtetuese me nr.15, datë 03.05.2011 dhe nr.22, datë 07.10.2008 në lidhje me konkurrimin e përgjegjësisë penale me përgjegjësinë administrative ose disiplinore;<sup>22</sup>
- Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.5/2013, nr.26/2012, nr.45/2011, nr.30/2012 dhe nr.35, datë 31.01.2013 në lidhje me rregullshmërinë e procesit penal, e cila mund të aplikohet *mutatis mutandis* në rastin e një procedure administrative, e ngjashme me procesin penal,<sup>23</sup> etj.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë ushtrimit të detyrës së inspektore, ka shfaqur aftësi të larta në drejtim të interpretimit të ligjit të zbatueshëm, si në mbështetje të opinionit të saj në lidhje me trajtimin dhe propozimin për zgjidhjen e çështjeve konkrete, ashtu edhe në mbështetje të argumenteve të saj lidhur me çështjet konflikt gjyqësor apo me analizën e gjetjeve në kuadër të raportit konstataues të vlerësimit etik profesional. Ajo i kushton rëndësinë e duhur, në raport me kompleksitetin e faktit konkret, interpretimit abstrakt të ligjit të zbatueshëm dhe dhënies së arsyeve dhe argumenteve mbi mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet e çështjes. Po ashtu, rezulton kujdesi i saj për të zbatuar por edhe marrë në analizë parimet e përgjithshme të së drejtës, si dhe për të pasuruar interpretimin e saj mbi ligjin e zbatueshëm dhe mënyrën e aplikimit të tij, me qëndrime të praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe GJK.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

### 1.B Arsyetimi ligjor

<sup>20</sup>Parashtrime të KLD-së para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me çështjen me ankuesen E.Gj

<sup>21</sup>Parashtrime të KLD-së para Gjykatës Kushtetuese lidhur me çështjen me kërkues N.T.

<sup>22</sup>Po aty

<sup>23</sup>Po aty

### ***1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 3 dokumentave të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit si dhe 5 dokumentet e përzgjedhura me short rezulton se subjekti i rivlerësimit {...} Osmanaj ka aftësi për të hartuar qartë të raportet e punës. Ajo i kushton rëndësi mbledhjes së plotë dhe të saktë të të dhënave duke ndjekur formatet standardet të raporteve sipas llojit të tyre (ankesë, vlerësim, përfaqësim në gjykatë). Ajo identifikon saktë rrethanat e çështjes dhe ligjin e aplikueshëm në paraqitjen e plotë të detajeve të verifikuara, si dhe në krijimin e dosjes në mënyrë të plotë dhe profesionale. I kushton rëndësinë e duhur rregullave drejtshkrimore në funksion të qartësisë së raportit, strukturës formale, analizës ligjore, formulimit të qartë dhe të saktë të konkluzioneve, përdor paragrafë sintetikë me fjali të kuptueshme që përcjellim mendimin juridik. Të dhënat statistikore përpunohen sipas standardeve të vendosura nga legjislacioni procedural në fuqi dhe sipas standardeve të caktuar në nenin 2 të Sistemit të Vlerësimit. (shih dokumentat nr.2, 6 dhe 7 për vlerësimet si dhe nr. 1, 4 dhe 5 për ankesat)”*.

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të miratuar me vendimin nr. 81, datë 20.06.2016, për periudhën 2013-2014, lidhur me aspektin e arsytimit ligjor (nën titullin “Aftësitë profesionale teknike”, në treguesin “Qartësia e hartimit të raportit”) konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 raporteve të përzgjedhura me short, konstatohet se inspektorja {...} Osmanaj ka aftësi shumë të mira për të hartuar raportet e punës. Ajo i kushton rëndësi anës formale të dokumentit, duke ndjekur format standard të raporteve sipas llojit të tyre (ankesë, vlerësim apo mbrojtje në gjykatë). Identifikon saktë rrethanat e çështjes dhe ligjin e aplikueshëm, si dhe tregohet e kujdesshme në analizën e kontekstit të fakteve. E strukturon mendimin juridik me fjali të kuptueshme, duke përdorur siç duhet kompetencat profesionale....Ajo i kushton rëndësinë e duhur rregullave drejtshkrimore në funksion të qartësisë së raportit. Në këto rrethana, ajo duhet të vlerësohet Shumë Mirë për Qartësinë e Hartimit të Raportit”*.

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes në përmbushje të detyrës, në varësi të natyrës së punës së kryer nga gjyqtari i komanduar.



Në pikën 3, të nenit 31 të Vendimit të KLD-së me nr.195/2/a, datë 05.07.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”, parashikohet se dokumenti në lidhje me verifikimin e ankesës, ndër të tjera, duhet të përmbajë: “...a. Inspektorin që ka kryer verifikimin. b. Objektin e verifikimit. c. Pretendimet e ngritura nga subjekti ankues. d. Pretendimet apo arsyetimet e mundshme të gjyqtarit. e. Parashtrimin e të dhënave bazë të rastit të verifikuar (momenti i regjistrimit të çështjes, seanca përgatitore, seancat gjyqësore, shkaqet e shtyrjes, momenti i përfundimit të gjykimit, depozitimi i vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore, ankimimi i vendimit, vendimi i gjykatave me të larta dhe përfundimet e tërhequra nga ato), duke përfshirë problematikat e ngritura nga subjekti ankues dhe ato të konstatuara kryesisht. f. Përfundimet e arsyetuara që dalin lidhur me ekzistencën në rastin konkret të shkeljeve të ligjit, si dhe tërheqja e konkluzioneve të arsyetuara nëse ato shkelje të lejuara përbëjnë shkelje të disiplinës në kuptim të ligjit. g. Propozimin lidhur me trajtimin e mëtejshëm të atij verifikimi”.

Në lidhje me raportet e kryera në kuadër të vlerësimit të gjyqtarëve, në nenin 27 të Vendimit të KLD-së me nr.261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, parashikohet se “Në raportin konstatues, përshkruhen: periudha e vlerësimit; të dhënat personale të gjyqtarit; dhoma apo seksioni ku ai ka ushtruar veprimtarinë gjatë periudhës së vlerësimit; masat disiplinore të marra ndaj tij gjatë asaj periudhe si dhe pasqyron në mënyrë të detajuar të dhënat e rezultuara nga verifikimet sipas nenit 23, pika 1 të sistemit. Në përfundim, inspektori bën propozimin për vlerësimin e gjyqtarit duke iu referuar secilit grup të kriterëve të vlerësimit”.

#### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, lidhur me këtë tregues vlerësohet qartësia, konciziteti dhe lehtësia në kuptimin dhe leximin e dokumenteve ligjore të hartuara nga gjyqtari i komanduar. Në rastin konkret, referuar të dhënave që rezultojnë nga dokumentet ligjore të analizuara, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja e komanduar, në pozicionin e inspektore, në aktet e përgatitura prej saj, është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme.

Rezulton se janë përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe (ë dhe ç), janë respektuar rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë aktet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte, në funksion të kuptueshmërisë dhe qartësisë së përmbajtjes së tyre. Nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i termave teknikë.

Gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektore përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, të qarta dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra tjetrës. Paragrafët dhe nënndarjet e përmbajtjes së dokumentit ligjor janë të lidhura me njëra tjetrën dhe nuk krijojnë shkëputje të logjikës së ndërtimit të tyre, brenda së njëjtës nënndarje të dokumentit ligjor apo në tërësi. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e dokumenteve ligjore burim vlerësimi dhe përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës,

përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin, sipas linjës së arsytimit logjik, i bën dokumentet ligjore lehtësisht të lexueshme dhe të organizuara sipas një vijueshmërie logjike.

## **KONKLUZIONI**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar në pozicionin inspektore tregon kujdes të posaçëm për pasqyrimin e qartë, konciz dhe të saktë të ankesës apo çështjes objekt verifikimi, fakteve të çështjes, ecurisë procedurale të trajtimit të rastit. Në rastin e vlerësimeve, i kushton rëndësi evidentimit të dokumenteve dhe informacioneve të marra në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, analizës së të dhënave të grumbulluara, arsytimit ligjor dhe paraqitjes së përfundimeve të nxjerra sipas kritereve matëse të vlerësimit. E njëjta shkallë kujdesi evidentohet në drejtim të kuptueshmërisë të mendimit të shprehur lidhur me përfaqësimet gjyqësore.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} Osmanaj ka aftësi në këtë aspekt. Nga vëzhgimi i 3 dokumenteve të prezantuara nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe të 5 dokumenteve të përzgjedhura me short ajo ka respektuar modelet e unifikuar standard të miratuar sipas llojit të punës dhe seksionit përkatës të ndarjes së veprimtarisë së Inspektorëve të IKLD, sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e Procedurave të Verifikimit të Ankesave dhe të Vlerësimit të Gjyqësorëve (shih dokumentin nr.1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7). Konkretisht janë vëzhguar 3 raporte verifikim ankesash, 3 raporte vlerësimi profesional të gjyqtarit dhe dy akte përfaqësimi të KLD në gjykatë. Raportet e saj nga ana formale paraqiten në nivelin e duhur dhe të kuptueshme menjëherë për llojin e objektit që*

*trajtojnë dhe shoqërohen me propozimet përkatëse drejtuar K/inspektore (shih dokumentin nr.1, 2, 4, 5, 6 dhe 7)”.*

Në aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të miratuar me vendimin nr. 81, datë 20.06.2016, për periudhën 2013-2014, lidhur me treguesin struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë (nën titullin “Aftësitë profesionale teknike”, në treguesin “Aftësia për të hartuar raportin sipas modeleve të caktuara”) konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 raporteve të përzgjedhura me short, konstatohet se në të gjitha rastet, inspektorja {...} Osmanaj ka respektuar me përpikmëri modelet e unifikuara sipas llojit të punës. Ajo përshkruan me saktësi faktet, duke treguar burimet e provave, identifikon ligjin e zbatueshëm dhe bën një analizë shumë të mirë të tij dhe jep me qartësi konkluzionet për çështjen. Konkretisht, janë vazhduar dy raporte të vlerësimit të gjyqtarëve, një raport i verifikimit të një ankese, 1 raport shqyrtimi paraprak të një ankese dhe 1 mbrojtje në gjykatë. Raportet e saj nga ana formale paraqitjen në nivelin e duhur dhe të kuptueshme menjëherë për llojin e tyre. Për pasojë, ajo duhet të vlerësohet Shumë Mirë për këtë aspekt”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Dokumentet ligjore të hartuar nga gjyqtarja e komanduar në varësi të llojit të tyre ndjekin strukturë të njëjtë dhe të standardizuar duke përmbajtur elementët thelbësore të tyre, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 31 të Vendimit të KLD-së me nr.195/2/a, datë 05.07.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së” apo nenit 27 të Vendimit të KLD-së me nr.261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, cituar më sipër në këtë raport.

Në varësi të llojit të tyre, dokumenteve ligjore organizohen sipas të njëjtës strukturë, brenda të njëjtës kategori dhe konkretisht:

- i) Relacionet për verifikimin e ankesave të përgatitura nga gjyqtarja e komanduar, përmbajnë:
  - Pjesën hyrëse të relacionit duke treguar subjektet/organet që urdhërojnë, miratojnë apo kryejnë inspektimin apo verifikimin përkatës, lëndën e verifikimit/inspektimit dhe datën e hartimit të raportit.*
  - Pjesën përshkruese-arsyetuese, të organizuar në nënndarje dhe të titulluara secila prej tyre sipas përmbajtjes duke evidentuar:*
    - a. Inspektorët përkatës, objektin e inspektimit dhe elementët procedurale lidhur me caktimin e çështjes, datën e verifikimit, si dhe bazën ligjore respektive të procedurës së zhvilluar.
    - b. Përmbajtjen e ankesës, në të cilën referohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet e ngritura në ankesë apo ato që përbejnë objekt inspektimi ose verifikimi.
    - c. Faktet e çështjes. Në këtë pjesë identifikohen faktet duke treguar edhe burimin e provave dhe informacioneve të marra në kuadër të verifikimit. Po ashtu, referohen dhe merren në analizë edhe parashtrimet e subjekteve sipas rastit (*gjyqtarit ndaj të cilit zhvillohet verifikimi*).

- d. Analiza e çështjes. Në këtë pjesë gjyqtarja e komanduar referon ligjin e zbatueshëm dhe e merr në analizë atë duke e përqasur me faktet që kanë rezultuar nga verifikimi, si dhe duke parashtruar argumentet ligjore lidhur me përfundimin e trajtimit dhe zgjidhjen e rastit.
- e. *Konkluzionin*, në pjesën e fundit referohet baza ligjore mbi të cilën mbështetet konkluzioni dhe sugjerimi i inspektores, së bashku me propozimin përkatës për zgjidhjen e trajtimin e rastit.

ii) Raportet konstatuese të përgatitura nga gjyqtarja e komanduar, për vlerësimin e gjyqtarëve, përmbajnë:

*Pjesën hyrëse* të raportit ku pasqyrohen të dhënat lidhur me periudhën e vlerësimit, të dhënat personale të gjyqtarit, gjykatën ku ushtron funksionin, si dhe masat disiplinore të marra gjatë asaj periudhe.

*Pjesën përshkruese e raporti*, në të cilën pasqyrohen në mënyrë të detajuar: a) të dhënat e rezultuara nga verifikimi i të dhënave të dala nga dosjet gjyqësore të pazgjedhur me short, b) vendimeve të prëzgjedhura nga vet gjyqtari, c) vendimeve të gjyqtarit të cenuara nga gjykata më të larta, d) të dhënat që dalin nga dosjes gjyqësore dhe që i përkasin çështjeve të gjykuar nga gjyqtari tej afateve kohore, e) të dhënat e rezultateve nga verifikimi i ankesave, f) të dhënat e rezultuara nga inspektimi i gjyqtarit apo gjykatës dhe g) vlerësimi i kryetari.

*Pjesën analizuese*, në të cilën inspektorja zhvillon analizën e gjetjeve nga verifikimi i dosjeve gjyqësore, për secilin prej tre grup kriteresh 1) grupi i aftësive profesionale të përgjithshme, organizuese dhe zbatuese, duke analizuar nën treguesit e tij: efektiviteti, metodologjia, shpejtësia dhe planifikimi; 2) grupi i aftësive profesionale juridike dhe teknike, duke analizuar nën treguesit e tij: qartësia e të shkruarit të vendimit dhe aftësia në drejtimin e procesit gjyqësor; 3) grupi i kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional, duke analizuar nën treguesit e tij: etika e gjyqtarit gjatë dhe jashtë procesit gjyqësor, respektimi i solemniteti dhe disiplinës në punë, pjesëmarrja dhe aktivizimi në aktivitete profesionale dhe shkrimet e botimet e ndryshme me natyrë juridike.

*Propozimi për vlerësimin*, në këtë pjesë të raportit bëhet propozimi për çdo kriter vlerësimi duke u pasqyruar në mënyrë tabelore.

iii) Dokumentat ligjorë për përfaqësime në procese gjyqësore (*parashtrime*), përmbajnë:

*Pjesën hyrëse* ku gjejnë pasqyrim të dhënat lidhur me gjykatën para të cilës paraqiten parashtrimet, palët ndërgjyqëse, objektin e shqyrtimit, bazën ligjore, si dhe kërkimet/prendimet e palës kërkuese/ankuese në mënyrë të përmbledhur.

*Pjesën përshkruese-arsyetuese*, është e ndarë në disa pjesë të listuara formalisht me tituj, si: mbi faktet, mbi parimet apo mbi të drejtat, aspekti material i procesit administrativ, dhe konkluzioni, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) elementin proceduralë lidhur me kompetencën e KLD, për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit; (ii) faktet thelbësore të çështjes objekt konflikti gjyqësor, duke integruar në të edhe provat e marra në shqyrtim gjatë procesit administrativ; (iii) pretendimet e ankuesit/kërkuesit të parashtruara në kërkesën/ankimin e tij, pasqyruar këto në mënyrë të përmbledhur;

(iv) vlerësimi e inspektores lidhur me pretendimet, në të cilin merr në analizë ligjin e zbatueshëm dhe argumentimin lidhur me çdo pretendim të parashtruar në ankim/kërkesë, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen.

*Konkluzionin*, në pjesën e fundit gjen pasqyrim qëndrimi përfundimtar lidhur me çështje objekt ankimi.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar në pozicionin e inspektores ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar sipas llojit dhe natyrës të dokumentit ligjor, pavarësisht përmbajtjes që ka secila ndarje. Në të gjitha dokumentet ligjore të analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike e rrjedhshmërisë së mendimit juridik, nga njëra pjesë e dokumentit ligjor në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin. Po kështu, e njëjta shkallë aftësie rezulton edhe nga raportet konstatues për vlerësimin e gjyqtari apo në dokumentat ligjorë për përfaqësime në procese gjyqësore.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### ***1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, lidhur me të tregues, vlerësohet cilësia e analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore, aftësia e gjyqtarit të komanduar për të identifikuar marrëdhënien shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet e së drejtës dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në lidhje me çështjen për trajtim. Në vlerësimin e këtij treguesi konsiderohet edhe shpeshësia e kthimit të dokumenteve ligjorë për shkak të cilësisë dhe argumentimin logjik.

Referuar dokumenteve ligjore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja e komanduar në cilësinë e inspektore, ka treguar kujdes dhe në analizimin e qartë të fakteve thelbësore të çështjes që lidhen me ankimin/çështjen objekt trajtimi, duke i analizuar ato në disa raste jo komplekse në mënyrë të përmbledhur dhe në rastet komplekse në mënyrë të detajuar, por në çdo rast në mënyrë logjike dhe të kuptueshme. Analiza e fakteve thelbësore apo çështjeve ligjore që janë bërë objekt shqyrtimi, bëhet duke integruar analizën ligjore të dispozitave të zbatueshme, në shërbim të konkluzionit të paraqitur në përfundim të analizës lidhur me çdo çështje të nevojshme për trajtim.

Në dokumentet ligjore burim vlerësimi spikat rëndësia që gjyqtarja e komanduar i kushton evidentimit të lidhjes shkak-pasojë mes fakteve të analizuarra dhe pasojës së shkaktuar dhe më pas vlerësimi i kësaj të fundit në raport me normën ligjore të zbatueshme. Dokumentet ligjore karakterizohen nga pesha specifike që zë në to komponenti analitik, posaçërisht në çështjet me karakter kompleks. Konkretisht, në drejtim të trajtimit të instituteve apo koncepteve ligjore të cilat analizohen në funksion të zgjidhjes së propozuar, veçohen:

- Në dokumentin ligjorë për përfaqësim në procesin gjyqësor me datë 21.04.2016 gjyqtarja e komanduar ka zhvilluar analizë të zgjeruar të konceptit të “së drejtës për t’u njoftuar, për të marrë pjesë në procedim, të drejtës për t’u dëgjuar dhe të drejtës për t’u mbrojtur” si elemente të së drejtës për proces të rregullt ligjor, duke integruar standardet e përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ dhe qëndrimet e GJEDNJ dhe GJK lidhur me këtë aspekt. Po në lidhje me këtë aspekt gjyqtarja e komanduar ka zhvilluar analizë të zgjeruar edhe të konceptit të “vendimit të arsyetuar” edhe ky si element i rëndësishëm i të drejtës për proces të rregullt ligjor, duke integruar edhe në këtë rast standardet e përcaktuar në nenin 6 të KEDNJ dhe qëndrimet e GJEDNJ dhe GJK në raport me pretendimin e ankuesit për mosnjoftimin efektivisht mbi procesin administrativ dhe cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, në funksion të konkluzionit të arritur mbi këto element të trajtuar.
- Në dokumentin ligjorë për përfaqësim në procesin gjyqësor me datë 05.10.2015 gjyqtarja e komanduar në raport me pretendimin e kërkuesit për cenim të parimit të sigurisë juridike dhe parimit të gjësë së gjykuar ka zhvilluar analizë të zgjeruar të këtyre parimeve, si parimet kryesore që qëndrojnë në themel jo vetëm të procedimit disiplinor, por të të gjithë procedurave në përfundim të të cilave një individ dënohet me një sanksion të caktuar qoftë civil, penal apo disiplinor, në funksion të konkluzionit se procesi i zhvilluar është i rregull dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në asnjë moment nuk janë cenuar këto parime.
- Në relacionin me datë 04.05.2015 gjyqtarja e komanduar merr në analizë pretendimet mbi shkelje të etikës së gjyqtarit, duke analizuar elementë të etikës dhe komunikimit të gjyqtarit, në funksion të konkluzionit se nuk konstatohet shkelje etike në adresë të gjyqtarit.
- Në relacionin me datë 28.04.2014 gjyqtarja e komanduar, pas paraqitjes dhe analizës së fakteve dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të verifikimit, zhvillon analizën ligjore të nenit 460/2 të K.Pr.Civile në raport me pretendimet e ankuesit për zvarritje të gjykimit. Analizë e cila mbështet sugjerimin e saj se në lidhje me mënyrën e vënies në lëvizje të dosjeve në gjykatat e apelit duhet të nxirret një rekomandim për unifikimin e

praktikave të ndryshme të cilat sjellin dhe mospërcaktimin e përgjegjësisë në rastet e zvarritjeve të pajustificuara të gjykimeve.

- Në raportet konstatare të vlerësimit etik dhe profesional, analiza e të dhënave të marra nga çdo burim vlerësimi, bëhet sipas një zhvillimi logjik dhe përmbajtësor të tyre, çka e bën lehtësisht të evidentueshme marrëdhënien shkak-pasojë, të dhëna burimore-analizë-rezultat.

*Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të ankuesit/kërkesit apo çështjeve objekt verifikimi, në dokumentet e analizuara, rezultojnë aftësia e gjyqtarës së komanduar për të veçuar dhe përmbledhur shkakun ose shkaqet thelbësore të çështjes, si dhe për të analizuar kur është rasti, ato fakte apo pretendime që kanë rëndësi thelbësore për trajtimin e rastit apo në funksion të evidentimit të çështjeve të ngritura për diskutim prej saj. Përmbajtja gjithëpërfshirëse evidentohet qartë edhe në raportet konstatare të vlerësimit, duke përmendur dhe analizuar në drejtim të të dhënave burimore edhe qëndrimi i gjyqtarit subjekt vlerësimi në rastin kur ai është intervistuar apo ka bërë vetëvlerësim si dhe të Kryetarit të gjykatës.*

Po ashtu, nga tërësia e dokumenteve burim vlerësimi dhe akteve të dosjes së rivlerësimit, rezultojnë se dokumentet ligjore të hartuara prej saj së bashku me sugjerimet/propozimet përkatëse, janë mbështetur dhe nuk janë kthyer në asnjë rast nga kryeinspektori apo Këshilli, apo janë pranuar nga gjykatat duke rrëzuar pretendimet e ankuesve, tregues ky i cilësisë së lartë të analizës dhe argumentimit logjik të saj dhe mendimit juridik të mbështetur dhe argumentuar ligjërisht.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, në dokumentet ligjore të analizuara, analiza ligjore dhe shkalla e argumentimit logjik, pavarësisht se në masë të ndryshme kushtëzuar nga natyra komplekse ose jo e çështjes, rezultojnë e lartë. Evidentohet qartë aftësia e gjyqtarës së komanduar për të ekstraktuar dhe analizuar aspektet thelbësore në lidhje me shkaqet e ngritura në ankesë/çështjen e marrë në shqyrtim, dhënia e argumenteve të plota dhe koncize lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit mbi këto fakte. Po ashtu, rezultojnë aftësia e saj për të evidentuar në raste specifike çështjet ligjore që duhet të vlerësoheshin nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u shoqëruar dhe me një analizë ligjore të saj lidhur me to. Analiza dhe argumentimi logjik ndjek kryesisht rregullin: fakt-çështje-normë-interpretim-konkluzion dhe argumentimi logjik ka vijueshmëri duke u evidentuar veçanërisht interpretimi individual i ligjit nga ana e saj si dhe aftësia për të evidentuar dhe ngritur çështje për të cilat duhet të bëhen objekt diskutimi nga Këshilli, me qëllim aplikimin e njëjtë në raste të ngjashme. Arsyetimi i dokumenteve ligjore në tërësinë e tyre është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura në ankesë apo në çështjen objekt kundërshtim, duke përmbushur standardet e një dokumenti ligjor të plotë, të qartë dhe të argumentuar ligjërisht. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së gjyqtarës së komanduar, aftësia e saj për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”. Në pikëzimin e këtij treguesi, konsiderohen edhe të dhënat lidhur me mungesën e rasteve kur dokumentet ligjore

të hartuara prej saj të jenë kthyer nga organet kontrolluese (Kryeinspektori) për plotësim apo korrigjim në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në dokumentet ligjore burim vlerësimi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSIA PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSIA ORGANIZATIVE

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit të komanduar në drejtim të aftësive organizative, në raport me pozicionin dhe rolin specifik që ai kryen, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë e tij për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat, pjesë e punës së tij, si dhe aftësinë për të qenë produktiv dhe eficient. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari i komanduar përdor kohën e tij si kur punon në autonomi, ashtu edhe në grup me të tjerë. Kjo aftësi vlerësohet sipas tre aspekteve: aftësia për të përballur ngarkesën në punë; efektiviteti dhe metodologjia dhe rregullshmëria dhe saktësia dhe mbajtjen e dokumentacionit.*

Në vendimin “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor” të miratuar me vendimin nr. 159, datë 05.04.2023, në nenin 21 të tij, lidhur me procedurën e gradimit, sa i përket aftësive organizative, është parashikuar se: “Në periudhën kalimtare, për gradimin e gjyqtarëve të komanduar të cilët kanë ushtruar detyrën e inspektorit në ish/Këshillin e Lartë të Drejtësisë, burim vlerësimi për kriterin e “Aftësive Organizative” shërbejnë edhe të dhënat statistikore të përfshira në dosjen e rivlerësimit kalimtar. Gradimi bëhet referuar treguesve sasiorë, kohorë dhe standarteve të përcaktuara në Vendimin nr. 36, datë 29.04.2015 të ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.



## 2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

### 2.A.a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore të pozicionit të punës si inspektor;
- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Inspektorja {...} Osmanaj gjatë periudhës së rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 është caktuar në Seksionin e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve. Sipas nenit 6/2 të Sistemit të Vlerësimit dhe nenit 6/1 të vendimit nr.36, datë 29.04.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”<sup>24</sup>, inspektori i Seksionit të Vlerësimit duhet të realizojë brenda 1 viti kalendarik 15 vlerësime profesionale të gjyqtarëve. Në vlerësimin e standardit sasior merret në konsideratë deri në masën 30% edhe volumi i detyrave të tjera të përmbushur nga Inspektorja. Sipas të dhënave të tabelave statistikore për efekt të përzgjedhjes me short të 5 dokumentareve përgjatë tre viteve kalendarike 08-10.2013-08.10.2016, subjekti i rivlerësimit {...} Osmanaj në cilësinë e Inspektore së KLD-së, ka përfunduar në total 153 çështje nga të cilat: 57 vlerësime etiko profesionale të gjyqtarëve, verifikimin e 42 ankesave për gjyqtarët, 31 përfaqësime të KLD në procese gjyqësore dhe 23 informacione të kryetarëve të gjykatave. Gjithashtu ajo është angazhuar në rishikimin tërësor të vlerësimeve të prapambetura për disa gjyqtarë. Inspektorja {...} Osmanaj ka realizuar 19 vlerësime etiko profesionale të gjyqtarëve në vit, mbi standardin prej 15 vlerësime në vit, pa llogaritur çështjet e tjera si dhe të dhënat e deklaruar nga vetë inspektorja dhe të detajuara në dokumentin e lëshuar nga KLD-ja, si përfshirjen e saj në një numër grupesh pune të ngritura nga KLD, përfaqësimet e KLD në gjykatë etj.”.*

Në aktin e vlerësimit të miratuar me vendim të KLD-së për periudhën kohore 18.03.2013 - 31.12.2014, në drejtim të aspektit sasior, pasi analizohen të dhënat, konkludohet se *“Duke iu referuar standardeve të punës dhe të dhënave statistikore të inspektore {...} Osmanaj nxirret përfundimi se ajo duhet të vlerësohet Shumë Mirë në aspektin sasior”.*

---

<sup>24</sup> Shih nenin 42/3 i ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës të komanduar si inspektore, referuar formatit të statistikave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për numrin e plotë të çështjeve të caktuara për trajtim gjatë periudhës së vlerësimit por administrohen të dhëna vetëm për çështjet e përfunduara prej saj nëpërmjet relacioneve paraprake apo përfundimtare për trajtimin e ankesave apo raporteve konstatues për vlerësimin profesional të gjyqtarëve apo për kryerjen e inspektimeve tematike. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit kalimtar së bashku me të dhënat statistikore të raportuara nga vetë gjyqtarja nëpërmjet dokumentacionit bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit profesional, si dhe të dhënave që rezultojnë për këtë tregues nga burimet e tjera të vlerësimit.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, së bashku me të dhënat e tjera të administruara në dosje, gjatë periudhës kohore 2013-2016, rezultojnë të dhënat statistikore si më poshtë:

**Sipas formularit të vetëvlerësimit, bazuar në të dhënat e pasqyruara në vërtetimin përkatës së KLD-së me nr. 4526 prot., datë 27.12.2016, rezulton se:**

- Numri i çështjeve të caktuara në vitin **2013** (*mars- dhjetor 2013*) është 107<sup>25</sup> dhe numri i relacioneve për trajtimin e çështjeve të caktuara, si dhe raporteve të rishikimit të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve për vitet 2005-2006 është 107. Po ashtu rezulton përfaqësimi i KLD-së në 4 çështje gjyqësore;
- Numri i çështjeve të caktuara në vitin **2014** (*janar- dhjetor 2014*) është 49 dhe numri i relacioneve për trajtimin e çështjeve të caktuara, si dhe raporte konstatues për vlerësimin e gjyqtarëve është 49. Po ashtu rezulton përfaqësimi i KLD-së në 17 çështje gjyqësore;
- Numri i çështjeve të caktuara në vitin **2015** (*janar- dhjetor 2015*) është 55 dhe numri i relacioneve për trajtimin e çështjeve të caktuara, si dhe raporte konstatues për vlerësimin e gjyqtarëve është 55. Po ashtu rezulton përfaqësimi i KLD-së në 18 çështje gjyqësore;
- Numri i çështjeve të caktuara në vitin **2016** (*janar-shtator 2016*) është 58 dhe numri i relacioneve për trajtimin e çështjeve të caktuara, si dhe raporte konstatues për vlerësimin e gjyqtarëve është 44. Po ashtu rezulton përfaqësimi i KLD-së në 7 çështje gjyqësore.

Referuar të dhënave statistikore mbi të cilat është zhvilluar procedura e shortit të cilat i përkasin periudhës 08.10.2013-08.10.2016 rezulton të kenë përfunduar duke hartuar relacionet përkatëse, trajtimin e 153 raporteve (*nga të cilat 22 raporte të natyrës relacione paraprake, 61 raporte konstatues vlerësimi, 31 raporte të verifikimit të ankesave dhe të informacioneve periodike të kryetarëve dhe 39 raporte për përfaqësimin e KLD në gjykim*).

---

<sup>25</sup> 38 çështje të caktuara dhe 69 materiale të vlerësimit profesional të viteve 2005-2006 të caktuara për tu rishikuar

Në total për periudhën 08.10.2013-08.10.2016 ka përfunduar **153 çështje** duke hartuar raportet përkatëse.

Sa i përket standardit sasior të punës së gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, referuar Sistemit të Vlerësimit të kohës, miratuar me vendimin nr. 36, datë 29.04.2015 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, në nenin 6, pika 2 parashikohet se: “2. *Aspekti sasior nënkupton aftësinë e kryeinspektorit dhe të inspektorit për të realizuar volumin normal të punës që i caktohet, duke përfshirë edhe detyrat e tjera që i ngarkohen. Volumi normal i punës nënkupton realizimin nga inspektori, brenda 1 viti kalendarik, të një ngarkese pune minimale si më poshtë:.....a. inspektori i Seksionit të Vlerësimit duhet të realizojë aktet e nevojshme dhe raportin konstatues për vlerësimin profesional për jo më pak se 15 gjyqtarë në vit;..... c. në vlerësimin e standardit sasior merret në konsideratë deri në masën 30% edhe volumi i detyrave të tjera të përmbushura nga inspektori, si më poshtë: i. pjesëmarrja në grupe pune; ii. përfaqësime gjyqësore; iii. procese raportimi; iv. mbajtje të dhënash; v. përpunimi i vendimeve gjyqësore të cenuara; vi. çdo detyrë tjetër”.*

Duke iu referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, rezulton se znj. {...}, për periudhën kohore 08.10.2013-08.10.2016 ka përfunduar **61** raporte konstatues për vlerësimin e gjyqtarit, duke tejkaluar standardin sasior me 16 vlerësime ose rreth 36% të standardit sasior në fuqi.

Po ashtu, rezulton angazhimi i saj në detyra të tjera të tilla (**totali 92 praktika të tjera të trajtuara**) si: trajtimi i ankesave apo kryerjen e inspektimeve tematike, për të cilat janë përgatitur edhe relacionet/raportet përkatëse; përfaqësimi në gjykatë; apo pjesëmarrja në grupin e punës për hartimin e Skemës së Vlerësimit të inspektorëve, të cilat në referim të nenit 6, pika 2, shkronja c) të vendimit nr. 36, datë 29.04.2015 të KLD-së, konsiderohen në vlerësimin tërësor në raport me volumin e punës së inspektorit.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} ka trajtuar në periudhën e vlerësimit 61 raporte konstatues për vlerësimin e gjyqtarit, duke tejkaluar standardin sasior të zbatueshëm me rreth 36%, si dhe ka qenë e angazhuar edhe në detyra të tjera. Për pasojë, në treguesin “Aftësia për të realizuar volumin normale të punës” aftësia e saj rezulton shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Aftësia për të realizuar volumn normale të punës”, gjyqtarja e komanduar pikëzohet me 25 pikë pasi rezulton se ka përmbushur dhe tejkaluar me 36 % standardin sasior të zbatueshëm për inspektorin në Seksionin e Vlerësimit si dhe ka qenë e angazhuar duke trajtuar edhe 92 praktika të tjera verifikimi ankese/informacioni periodik i kryetarit/përfaqësime gjyqësore si dhe ka marrë pjesë në grupe pune për nevoja të ish/IKLD-së.

### **2.A.b. Aftësia për të respektuar afatet**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore të pozicionit të punës si inspektor;
- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “.....Nga 3 dokumentat e paraqitur nga vet subjekti i rivlerësimit si dhe 5 dokumentet e përzgjedhura me short rezulton se 2 prej tyre përkasin kategorisë përfaqësime të KLD në gjykatë, pa afte kohor, ndërsa nga 6 dokumentat e tjera 2 prej tyre janë realizuar jashtë afateve standard të parashikuar nga aktet nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari (shih dokumentin nr.4, 5), ndërsa 4 dokumentet janë realizuar brenda afatit (shih dokumentin nr.1, 2, 6 dhe 7), ose 33.33% e tyre, nën standardin prej 40% të përcaktuar nga sistemi i Inspektorëve....”.

Në aktin e vlerësimit të miratuar me vendim të KLD-së për periudhën kohore 18.03.2013-31.12.2014, në drejtim të treguesit të shpejtësisë, pasi analizohen të dhënat, konkludohet se: “Sipas tabelës statistikore, në vitin 2013 inspektorja {...} Osmanaj ka realizuar 8 raporte jashtë afateve standard, të cilat duke i krahasuar me 124 raporte të hartuara gjithsej zënë masën 6.5%. Ndërsa në vitin 2014, inspektorja {...} Osmanaj ka realizuar 4 raporte jashtë afatit standard, të cilat të krahasuara me 65 raporte të hartuara gjithsej zë masën 6.16%. Në vlerësimin e kësaj aftësie të inspektore {...} Osmanaj duhet konsideruar edhe ngarkesa e lartë sasimore e saj për shkak të numrit të ulët të inspektorëve në Inspektorat. Për pasojë, ajo duhet të vlerësohet Shumë Mirë për shpejtësinë”.

Në nenin 6, pika 4 të vendimit të KLD-së nr. 36/2016 parashikohet se: “4. Aspekti i shpejtësisë nënkupton aftësinë e kryeinspektorit dhe të inspektorit për të zgjidhur dhe

përfunduar në afatin e duhur kohor çështjet që i janë caktuar për trajtim. Për kryeinspektorin, vlerësohet edhe aftësia për të rishikuar dhe vlerësuar në kohën e duhur çështjen e caktuar. a. afati i duhur kohor nënkupton realizimin nga inspektori të raportit brenda afatit të caktuar shprehimisht nga ligji, akti nënligjor apo organi kompetent për caktimin e afatit. Caktimi shprehimisht i afatit nënkupton saktësimin e një datë apo shënimit të llojit të afatit. Llojet e afatit janë urgjent, prioritar dhe normal. Afati i caktuar urgjent nënkupton hartimin e raportit brenda 48 orëve nga caktimi i detyrës. Afati prioritar nënkupton hartimin e raportit, duke i dhënë përparësi atij në raport me detyrat e tjera dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë. Afati normal nënkupton hartimin e raportit jo më vonë se 30 ditë. b. për efekt të standardit kohor të punës, numri i rasteve në të cilat raporti hartohet jashtë afateve nuk duhet të kalojë 40% të numrit të përgjithshëm të raporteve të hartuara nga inspektori gjatë vitit kalendarik. Në vlerësimin e këtij standardi minimal mbahet në konsideratë volumi i përgjithshëm i punës së inspektorit nga pikëpamja sasiore, si dhe kushtet e vështira të punës”.

Në nenin 27, pika 3 të vendimit të KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” parashikohet se: “3. Inspektori i ngarkuar, pasi grumbullon aktet dhe krijon dosjen e vlerësimit të gjyqtarit apo kryetarit të gjykatës, jo më tej se 30 (tridhjetë) ditë, harton raportin konstatues të vlerësimit”.

Pavarësisht se në tabelat me të dhëna statistikore nuk administrohen të dhëna për kohën e trajtimit të të gjitha çështjeve (ankesave) të caktuara për trajtim për subjektin, për çdo vit kalendarik dhe as për të gjithë periudhën e vlerësimit në tërësi, nga të dhënat burimore lidhur me çështjet e përzgjedhura nga inspektorja dhe çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim rezultojn se:

- (i) *Relacioni me datë 20.11.2013 “Për verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtarin F.V.”.* Rezulton se materiali, me urdhrin nr. 1444/2 prot., datë 22.10.2013 të Kryeinspektorit, i ka kaluar për trajtim inspektorëve, ndër të cilët edhe znj.{...}, duke u përcaktuar afati i hartimit të raportit deri në datë 25.11.2013. Relacioni ka përfunduar në datë 20.11.2013, pra për një kohëzgjatje prej **29 ditësh nga momenti i caktimit**, brenda afatit të përcaktuara nga titulluari dhe për pasojë edhe brenda afatit normal të verifikimit prej 30 ditësh;
- (ii) *Raporti konstatues për vlerësimin e gjyqtarës M.P., për periudhën 2007-2009 me datë 13.03.2015.* Rezulton se për kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës M.P inspektorja {...} Osmanaj është caktuar me urdhrin nr.686 prot., datë 20.02.2015, ku në mbështetje të nenit 27 të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 është përcaktuar afati prej 30 (tridhjetë) ditësh për grumbullimin e akteve, krijimin e dosjes dhe hartimin e raportit konstatues të vlerësimit. Raporti konstatues ka përfunduar në datën 13.03.2015, pra për një kohëzgjatje prej **21 ditë**, brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 27 të vendimit 261/2, datë 14.04.2010;
- (iii) *Parashtrime të Këshillit të Lartë të Drejtësisë para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me datë 21.04.2016.* Rezulton se autorizimin nr.1635 prot, datë 21.04.2016 për përfaqësimin e KLD në Gjykatën Kushtetuese, për gjykimin e çështjes me kërkues

N.T., është caktuar kryeinspektori i KLD dhe inspektorja {...} Osmanaj. Brenda datës së caktimit në cilësinë e përfaqësueses së KLD, nga ana e inspektores janë përgatitur parashtrimet, duke u protokolluar me nr.1635/1 port., datë 21.04.2016. Edhe pse në aktet e administruar nuk rezulton që të jetë përcaktuar afat për përgatitjen e parashtrimeve, ato rezulton të jenë përgatitur **brenda ditës së caktimit**, si dhe janë paraqitur në Gjykatën Kushtetuese përpara zhvillimit të seancës plenare dhe si të tilla do të konsiderohen brenda afatit prioritar, prej 10 ditësh.

- (iv) *Relacioni me datë 28.04.2014 "Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtaren M.R."*. Rezulton se materiali, me urdhrin nr. 3389/2 prot., datë 10.01.2014 të Kryeinspektorit, i ka kaluar për trajtim inspektorëve, ndër të cilët edhe znj.Osmanaj, duke u përcaktuar afati i hartimit të raportit deri në datë 14.02.2014. Relacioni ka përfunduar në datë 28.04.2014, pra për një kohëzgjatje prej **108 ditësh nga momenti i caktimit**, jashtë afatit të përcaktuara nga titulluari, si dhe jashtë afatit normal të verifikimit prej 30 ditësh.
- (v) *Relacioni me datë 02.04.2014 "Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtaren Dh.B."*. Rezulton se materiali, me urdhrin nr. 246/1 prot., datë 04.02.2014 të Kryeinspektorit, i ka kaluar për trajtim inspektorëve, ndër të cilët edhe znj.Osmanaj, duke u përcaktuar afati i hartimit të raportit deri në datë 06.03.2014. Relacioni ka përfunduar në datë 02.04.2014, pra për një kohëzgjatje prej **57 ditësh nga momenti i caktimit**, jashtë afatit të përcaktuara nga titulluari, si dhe jashtë afatit normal të verifikimit prej 30 ditësh.
- (vi) *Raporti konstatues për vlerësimin e gjyqtarit Q.Z., për periudhën 2005-2006 me datë 10.05.2015*. Rezulton se për kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Q.Z. inspektorja {...} Osmanaj është caktuar me urdhrin nr.1425 prot., datë 24.04.2015, ku në mbështetje të nenit 27 të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 është përcaktuar afati prej 30 (tridhjetë) ditësh për grumbullimin e akteve, krijimin e dosjes dhe hartimin e raporti konstatues të vlerësimit. Raporti konstatues ka përfunduar në datën 10.05.2015, pra për një kohëzgjatje prej **16 ditë**, brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 27 të vendimit 261/2, datë 14.04.2010;
- (vii) *Raporti konstatues për vlerësimin e gjyqtares L.L., për periudhën 2007-2009 me datë 24.07.2015*. Rezulton se për kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares L.L. inspektorja është caktuar me urdhrin nr.2293 prot., datë 07.07.2015, ku në mbështetje të nenit 27 të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 është përcaktuar afati prej 30 (tridhjetë) ditësh për grumbullimin e akteve, krijimin e dosjes dhe hartimin e raporti konstatues të vlerësimit. Raporti konstatues ka përfunduar në datën 24.07.2015, pra për një kohëzgjatje prej **17 ditë**, brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 27 të vendimit 261/2, datë 14.04.2010;
- (viii) *Parashtrime të Këshillit të Lartë të Drejtësisë para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me datë 05.10.2015*. Rezulton se autorizimin nr.867/10 prot, datë 25.09.2015 janë caktuar për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të KLD-së, në çështjen me ankuesë E.Gj. që gjykohen përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë kryeinspektori i KLD dhe inspektorja {...} Osmanaj. Parashtrimet lidhur me këtë çështje janë përgatitur në datën 05.10.2015, protokollar me aktin nr.867/11 prot. Pavarësisht se në aktet e administruar nuk rezulton që të jetë përcaktuar afat për përgatitjen e parashtrimeve, ato

rezulton të jenë përgatitur dhe depozituar përpara zhvillimit të seancës gjyqësore, datë 05.10.2015 dhe si të tilla do të konsiderohen brenda afatit prioritar, prej 10 ditësh.

Sa më sipër, rezulton se në 8 (tetë) çështjet e analizuar, 2 (dy) materialet janë trajtuar dhe përfunduar nga gjyqtarja e komanduar {...}, në cilësinë e inspektore, jashtë afateve të zbatueshme sipas aktit nënligjor. Por të dy këto materiale i përkasin periudhës që ajo është vlerësuar nga Kryeinspektori (vitit 2014), të cilat referuar këtij akti vlerësimi, në totalin e çështjeve të trajtuara prej saj zënë vetëm 6.16%. Ndërsa për vitin 2013 raporti i materialeve të trajtuara jashtë afatit, rezulton 6,5 %. Për vitet 2015 dhe 2016 nga të dhënat burimore nuk evidentohen trajtime të çështjeve jashtë afateve urgjente/ prioritare apo normale. Për këtë arsye aftësitë e saj në drejtim të shpejtësisë së trajtimit të çështjeve, në aktin e vlerësimit të miratuar me vendim të KLD-së, për vitet 2013-2014, rezulton të jenë vlerësuar maksimalisht.

## **KONKLUZIONI**

Referuar Sistemit të Vlerësimit të zbatueshëm në rastin konkret, të dhënave burimore në lidhje me kohën e trajtimit të çështjeve, si dhe të dhënave të tjera nga burimet e vlerësimit si dhe duke konsideruar në analizën logjike të tyre edhe ngarkesën në punë të znj. {...} në periudhën e vlerësimit, si dhe numri i rasteve në të cilat raporti hartohet jashtë afateve nuk tejkalon 40% të numrit të përgjithshëm, përkundrazi zë vetëm 6,16% të çështjeve të trajtuara prej saj në vitin 2014 dhe 6,5% në vitin 2013, aftësia e saj në drejtim të respektimit të afateve është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Aftësia për të respektuar afatet”, aftësia e gjyqtarës së komanduar vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë, pasi gjatë vitit 2013 dhe 2014 kur evidentohen rastet në të cilat raporti është hartuar jashtë afateve, ky raport është përkatësisht 6,5% dhe 6,16%, ndërkohë që rezulton i tejkaltuar me 36 % standardi sasior pa përfshirë këtu pjesëmarrjen e inspektore ne grupe pune si dhe trajtimin prej saj të 92 praktikave të tjera.*

## **2.B. Efektiviteti dhe metodologjia**

### **2.B.a Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81,

datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, sa i përket këtij treguesi, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 3 dokumenteve ligjorë të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe 5 dokumentat e përzgjedhura me short, konstatohet se Inspektorja {...} Osmanaj ka aftësi shumë të mira metodologjike. Thelbi i detyrës kuptohet saktësisht prej saj dhe përmbushet në funksion të respektimit të kornizës ligjore e n/ligjore dhe afateve të vendosura. Në 8 dokumentet ligjorë të vëzhguara, veprimet procedurale dokumentohen rregullisht dhe qartë dhe në asnjë rast nuk ka mangësi në kryerjen e detyrave përkatëse. Për çdo veprim procedural janë mbajtur aktet e domosdoshme të cilat i janë bashkëngjitur aktit të verifikimit apo vlerësimit. Baza ligjore identifikohet lehtësisht prej saj në hartimin e raporteve. Ka aftësi shumë të mira për të paraqitur saktë nga pikëpamja formale aktet në funksion të uniformizimit të praktikave. Kështu projektaktet e vlerësimit etiko profesional të gjyqtarëve ( shih dokumentin nr.2, 6 dhe 7) si dhe raportet e verifikimit e ankesave (shih dokumentin nr.1, 4, 5) paraqiten të standardizuara. Inspektorja menaxhon mirë aftësinë e saj duke identifikuar natyrën e punës që duhet përmbushur. Në organizmin dhe planifikimin e punës ajo ka përballuar volum tepër të lartë ngarkese, referuar kjo edhe fakti të periudhës së rivlerësimit ku Inspektorati ka funksionuar me organikë të paplotësuar deri në 40% mungesë”.*

Në aktin e vlerësimit të miratuar nga KLD me vendimin nr. 81, datë 20.06.2016, për periudhën e vlerësimit 18.03.2013-31.12.2014, në lidhje me treguesin e metodologjisë së punës, analizohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 raporteve të përzgjedhura me short konstatohet se inspektorja {...} Osmanaj ka aftësi shumë të mira metodologjike. Ajo arrin të kuptojë saktësisht thelbin e detyrës, që i ngarkohet. Inspektorja {...} Osmanaj e menaxhon shumë mirë kohën dhe burimet e tjera në dispozicion në funksion të realizimit të afateve kohore, pa anashkaluar saktësinë e veprimeve që kryen. Identifikon bazën ligjore që duhet zbatuar dhe e përmbush veprimin procedural sipas ligjit, duke e dokumentuar rregullisht dhe qartë. Vepron me qetësi dhe i kushton rëndësi paraqitjes formale të veprimeve. Gjithashtu, i kushton rëndësinë e duhur edhe thellimit të analizës ligjore të treguesve të rastit konkret. Për pasojë inspektorja {...} Osmanaj duhet të vlerësohet “Shumë Mirë” për Metodologjinë”.*

Në Metodologjinë e Pikëzimit në lidhje me këtë tregues parashikohet se vlerësohet aftësia për të menaxhuar në mënyrë efektive kohën dhe burimet e tjera në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës. Po ashtu, vlerësohet aftësia për të evidentuar çështjet që kanë përparësi trajtimi apo ato me probleme procedurale, si dhe aftësia për të qenë krijues dhe për të propozuar ide të reja për organizimin dhe menaxhimin efektiv të punës. Ndërkohë, në nenin 6, pika 3 të vendimit të KLD-së nr. 36/2015, në lidhje me metodologjinë e punës, parashikohet se: *“3. Aspekti metodologjik nënkupton aftësinë e kryeinspektorit dhe të inspektorit për të qenë*



*efektiv në menaxhimin e kohës dhe të burimeve të tjera, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës. Në këtë aspekt përfshihet edhe aftësia për të përdorur sa më mirë kohën dhe burimet në dispozicion për përfundimin e detyrave të ngarkuara në kohën e duhur në raport me sasinë e punës. Gjithashtu, ky aspekt përfshin edhe aftësinë e inspektorit për të qenë krijues dhe për të propozuar ide të reja për përmirësimin e punës.....”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:***

Nga 5 (pesë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, si dhe në 3 (tre) dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti, rezulton kujdesi i gjyqtarës së komanduar për të përcaktuar, ndjekur dhe dokumentuar veprimet procedurale në drejtimet e nevojshme në lidhje me trajtimin e rastit apo dokumentimin dhe grumbullimin e materialeve për kryerjen e vlerësimeve të gjyqtarëve. Rezulton kujdesi i saj për të përcaktuar qartë veprimet procedurale të çështjeve të caktuara për trajtim, konkretisht:

(i) Në rastet e trajtimit të ankesave – rezulton kujdesi i saj për të përcaktuar qartë që në momentin e marrjes së materialit, aspektet procedurale që lidhen me mbledhjen e dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm për verifikimin e ankesës, kërkimin dhe marrjen e tyre nga të tretët (kryesisht nga gjykatat respektive), kryerja dhe dokumenti i saktë dhe i plotë i veprimeve verifikuese të kryera në gjykatë, hartimi i raporteve përkatëse, administrimi i të dhënave dhe dokumenteve të marra në kuadër të verifikimit, si dhe pasqyrimi i tyre në raportet respektive. Po ashtu, rezulton kujdesi maksimal i saj për kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve të komunikimit dhe marrjes së shpjegimeve për rastin nga gjyqtari ndaj të cilit kryhet verifikimi apo subjekte të tjera (*p.sh kryetari i gjykatës, sekretares gjyqësore*). Të gjitha veprimet procedurale në kuadër të verifikimit dhe më pas trajtimit të ankesës, referuar burimeve të vlerësimit, janë kryer në kohë dhe me efektivitet.<sup>26</sup>

(ii) Në rastet e kryerjes së vlerësimeve etiko profesionale të gjyqtarëve, evidentohet kujdesi i inspektores për dokumentin dhe grumbullimin e të gjithave materiale për kryerjen e vlerësimit të gjyqtarit, të përcaktuar në nenet 19 e vijues të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD. Në çdo rast, shorti për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim është dokumentuar rregullisht me procesverbalin përkatës, duke pasqyruar në të mënyrë të plotë, të dhënat përmbledhëse të veprimeve të verifikimeve të kryera. Gjithashtu, në rastin kur nga gjyqtari subjekt vlerësimi është kërkuar intervista personale, në mbështetje të nenit 26 të vendimit 261/2, datë 14.04.2010, inspektorja ka mbajtur rregullisht procesverbalin për dokumentimin e kësaj interviste, e cila është bërë pjesë e dosjes së vlerësimit.<sup>27</sup>

Në aktet e dokumenteve ligjore të administruara, rezulton e qartë aftësia e gjyqtarës së komanduar për të menaxhuar në mënyrë efektive kohën por edhe për të kryer veprime verifikimi të plota dhe të sakta, si dhe për t'i dokumentuar ato në mënyrë të rregullt dhe të plotë. Po ashtu, evidentohen aftësitë e saj për të propozuar kryerjen e një inspektimi në

---

<sup>26</sup> “Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtarin F.V.”, datë 20.11.2013; “Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtaren Dh.B.”, datë 02.04.2014 dhe “Relatim mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtaren M.R.”, datë 28.04.2014

<sup>27</sup> Shih dokumentin nr.2 lidhur me vlerësimin etiko profesional të gjyqtarës M.P.

lidhje me mënyrën e vënies në lëvizje të dosjeve në gjykatat e apelit dhe nxjerrjen e një rekomandimi për unifikimin e praktikave të ndryshme të cilat sjellin mos përcaktimin e përgjegjësisë në rastet e zvarritjeve të pajustificuara të gjykimeve, evidentuar në mënyrë specifike në treguesit lidhur me aftësitë profesionale të saj në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, si dhe që rezultojnë nga praktika përkatëse në trajtimin e administruar në dosjen e rivlerësimit.<sup>28</sup>

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit dhe të dhënave që rezultojë prej tyre, rezulton e qartë aftësia e gjyqtarës së komanduar, gjatë kryerjes së detyrës së inspektore, në drejtim të përcaktimit dhe zbatimit të një metodologjie punë të qartë, të strukturuar dhe efektive për trajtimin e rasteve konkrete. Rezulton aftësia e saj për ndjekjen e kësaj metodologjie standarde në funksion të efektivitetit dhe trajtimit në kohë të ankesave, si dhe kryerjen në kohë të vlerësimeve të gjyqtarëve. Metodologjia e trajtimit dhe verifikimit të rasteve, në drejtim të procedurës së kryer dhe dokumentimit të saj, zhvillohet në çdo rast në respektim të parashikimeve të nenit 30 të vendimit nr. 195/2/a, datë 05.07.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar. Po kështu, metodologjia për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme për vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve, në drejtim të procedurës së kryer dhe dokumentimit të saj, zhvillohet në çdo rast në respektim të parashikimeve të nenit 43 të vendimit 195/2/a, datë 05.07.2006, si dhe në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara në nenin 45 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushteti gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit të KLD nr.261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”.

Gjyqtarja zbaton një metodologji efektive në drejtim të kryerjes së veprimeve për verifikimin e ankesës, apo për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme për vlerësimin e gjyqtarëve, mbledhjen e dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm, dokumentimin e procedurës që ndiqet për çdo rast, në funksion të qëllimit final që konsiston në trajtimin/kryerjen profesional dhe në një kohë sa më të arsyeshme të çdo ankese, apo vlerësimi.

## **KONKLuzioni**

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit në funksion të organizimit të punës për trajtimin e rasteve, apo kryerjen e vlerësimeve profesionale rezulton angazhimi maksimal i gjyqtarës së komanduar për ndjekjen e një metodologjie efektive në drejtim të organizimit të punës. Për pasojë, aftësitë e saj për këtë tregues janë shumë të larta dhe pikëzohen maksimalisht.

---

<sup>28</sup> Shih relacionin e datës 28.04.2014 mbi verifikimin e ankesës së ardhur për gjyqtaren M.R

*Shkalla e aftësisë dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në treguesin “Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

## **2.C Rregullshmëria dhe saktësia**

### **2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Për 5 (pesë) dokumentet e përzgjedhura me short në kuadër të procedurës së rivlerësimit kalimtar lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit rezulton se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve ndjek kryesisht të njëjtën linjë, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dokumentacionit në rastet e trajtimit të ankesave, fillon nga praktika e ankesës përcjellë nga Kryeinspektori së bashku me shënimet ose urdhrin përkatës të verifikimit/inspektimit, vijon me dokumentet dhe informacionet e kërkuara dhe administruara në lidhje me verifikimin e ankesës, relacioni paraprak kur është rasti, veprimet dhe dokumentet e kryera pas tij në funksion të inspektimit, për të përfunduar me relacionin përfundimtar për trajtimin e ankesës. Rregullshmëria dhe plotësia e dokumentacionit në çdo procedurë të kryer, referuar akteve të çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, respekton parashikimet e neneve 30 dhe 31 të vendimit nr. 195/2/a, datë 05.07.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Renditja e dokumentacionit në rastet e vlerësimeve të gjyqtarëve, fillon me urdhrin përkatës për fillimin e procedurës së vlerësimit të gjyqtarit dhe caktimin e inspektorit përgjegjës për kryejnë e vlerësimit, vijon me procesverbalin për pasqyrimin e të dhënave përmbledhëse të veprimeve të kryera për krijimin e dosjes së vlerësimit, dokumentimin e intervistimit të gjyqtarit subjekt vlerësim, në rastet kur është kërkuar nga gjyqtari, raporti konstatues për vlerësimin e gjyqtarit, projektakti i vlerësimit të gjyqtarit, për të përfunduar me vlerësimin

përfundimtar të gjyqtarit. Rregullshmëria dhe plotësia e dokumentacionit në çdo procedurë vlerësimi të kryer, referuar akteve të çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, respekton parashikimet e nenit 43 të vendimit nr. 195/2/a, datë 05.07.2006 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar dhe nenet 24, 26 dhe 27 të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010.

Të gjitha materialet e administruara paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të renditura në mënyrë kronologjike dhe mund të shfrytëzohen pa vështirësi.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjes janë të administruara dhe renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur rendin kronologjik të paraqitjes apo hartimit të tyre dhe në tërësi e bëjnë materialin lehtësisht të shfrytëzueshëm nga çdo përdorues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### **2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Për 5 (pesë) dokumentet e përzgjedhura me short në kuadër të procedurës së rivlerësimit kalimtar së bashku me praktikat e trajtimit të rasteve, aktet e dosjeve të administruara janë të plota dhe të sakta.

Nuk evidentohet përfshirja në dosje e akteve që nuk i përkasin çështjes konkrete dhe nuk rezultojnë mungesa të akteve. Nuk evidentohet përfshirja në dosje (praktikën dokumentare përkatëse) e akteve që nuk i përkasin çështjes konkrete dhe po ashtu nuk evidentohen mungesa të akteve që i përkasin asaj çështje.

Çdo veprim verifikues i kryer apo çdo veprim tjetër procedural në funksion të verifikimit të ankesës apo vlerësimi të kryer është dokumentuar dhe administruar në praktikën respektive.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjeve (praktikave të verifikimit) janë të rregullta, të plota dhe të sakta në aspektin formal të tyre. Nuk rezultojnë mungesë të dokumenteve në praktikat e trajtimit të rasteve burim vlerësimi dhe as prania e akteve që nuk i përkasin çështjes respektive.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSIA ORGANIZATIVE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

### **3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### **3.A. Etika në punë**

##### **3.A.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81,

datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;

- Të dhëna nga burimet arkivore të Këshillit/KLD-së.
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit.

Lidhur me këtë aspekt, në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} Osmanaj respekton rregullat e etikës në komunikim me eprorët, kolegët e saj, gjyqtarët, administratën gjyqësore dhe qytetarët. Ajo karakterizohet nga respekti që gëzon tek kolegët e punës, është e hapur për të diskutuar dhe zgjidhur çështje brenda strukturës që zbatohen për herë të parë në funksion të praktikave të mira. Ka aftësi komunikuese edhe në procesin e pritjes së ankesave me qytetarët. Ajo respekton disiplinën në punë, duke punuar edhe jashtë orarit zyrtar dhe njofton rast kur ka pengesa të justifikuar të paraqitjes në detyrë. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave të KLGJ rezulton se nuk ka ankesa nga qytetarët apo procedime disiplinore ndaj saj”*.

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të miratuar me vendimin e KLD-së nr.81, datë 20.06.2016, për periudhën e vlerësimit 18.03.2013-31.12.2014, lidhur me etikën në punë (nën titullin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave gjyqësorit”, në treguesin “Etika dhe disiplina në punë”), konkludohet se: *“Inspektorja {...} Osmanaj ka mbajtur komunikim tepër korrekt me eprorët dhe kolegët. Është e urtë, e sinqertë dhe e dëgjueshme, respekton kolegët dhe respektohet prej tyre. Është e hapur për të diskutuar mbi çështje të punës, duke dëgjuar dhe reflektuar për ndryshimet eventuale në funksion të harmonizimit të praktikave të punës. Ka aftësi komunikuese edhe në procesin e pritjes së ankesave me qytetarët. Lidhur me disiplinën në punë, inspektorja {...} Osmanaj karakterizohet nga ndjenja e përgjegjësisë në përmbushjen e detyrës, respekton orarin zyrtar, si dhe tregohet e kujdesshme për të njoftuar raste të pengesave të paraqitjes në punë. Nuk ka pasur raste të mosparaqitjes në detyrë pa arsye. Në këto rrethana, ajo duhet të vlerësohet Shumë Mirë për Etiken dhe Disiplinën në Punë”*.

#### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD/KLGJ dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, sipas raportit analitik të rivlerësimit dhe tërësisë së akteve të dosjes, rezulton se ndaj saj nuk është paraqitur dhe trajtuar asnjë ankesë. Të njëjtat fakte rezultojnë edhe nëse i referohemi vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 291, datë 04.09.2020 ku nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie, e cila mund të dëshmojë për cenim të etikës në punë nga ana e gjyqtarës së komanduar.

Nga raporti i analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe vlerësimi etik dhe profesional i miratuar me vendimin e KLD-së nr. 81, datë 20.06.2016 evidentohet angazhimi maksimal i saj për të respektuar etikën në punë në të gjitha aspektet dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për cenimin apo vënien në diskutim të këtij aspekti.

Nga tërësia e akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarës gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës apo jashtë saj. Po ashtu, evidentohen aftësi tepër të larta të saj në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion, sjellja e matur, objektive dhe tepër korrekte e saj.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarës së komanduar, ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri maksimale në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja e komanduar ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B. Integriteti i gjyqtarit të komanduar**

#### **3.B.a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Të dhëna nga burimet arkivore të Këshillit/KLD-së.
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së

prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe figurës.

Lidhur me këtë aspekt, në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, konkludohet se: *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} Osmanaj dhe nga 8 dokumentat e vëzhguara konstatohen komunikuese, ndjenjën e përgjegjësisë, integritet dhe aftësi në ushtrimin e detyrës. Nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Ajo ka ditur të ndërtojë marrëdhënie profesionale të sakta dhe në periudhën e rivlerësimit nuk ka pasur ndaj saj ankesa dhe raste të fillimit të procedimeve disiplinore”*.

Në aktin e vlerësimit profesional të miratuar me vendimin nr. 81, datë 20.06.2016 të KLD-së, për periudhën e vlerësimit 18.03.2013-31.12.2014, lidhur me treguesit e integritetit, konkludohet se: *“Inspektorja {...} Osmanaj ka shfaqur integritet dhe nuk ka pasur raste që të jetë ndikuar apo t'i jetë nënshtruar presionit të jashtë. Në periudhën e vlerësimit, ndaj saj nuk është paraqitur asnjë ankesë. Po ashtu, ndaj saj nuk ka patur asnjë rast për fillimin e procedurave disiplinore. Në këto rrethana, ajo duhet të vlerësohet Shumë Mirë për Integritetin”*.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD/KLGJ dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore. Gjithashtu nuk rezulton të jenë paraqitur ankesa e për pasojë nuk janë trajtuar të tilla.

Nga vendimin nr.291, datë 04.09.2020 të KPK, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: *“...66. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën Vetting, si dhe në deklaratimet periodike ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre, është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës. 67. Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2007, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm vjetor dhe përfundimtar ka rezultuar një bilanc pozitiv, pa mungesa të burimeve financiare”*.

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sa i përket vlerësimit të figurës, konkludohet se: *“69. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese, përgjatë hetimit administrativ të kryer*



*nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte të reja lidhur me këtë kriter. Për rrjedhojë, Komisioni – pas hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016 dhe bazuar në dokumentet e administruara, – në vlerësim të kriterit të kontrollit të figurës, në tërësi, arrin në përfundimin se nuk janë gjetur fakte apo rrethana që mund të çonin në një konkluzion të ndryshëm nga ai i arritur nga DSIK”.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarës.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 40 pikë.*

### **3.C Paanësia e gjyqtarit të komanduar**

#### **3.C.a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Lidhur me këtë aspekt, në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, konkludohet se: *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dokumentet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...} Osmanaj. Nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa ndaj saj për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të paanësisë përgjatë përmbushjes së detyrës, si nga qytetarët ashtu edhe nga gjyqtarët. Në 8 dokumentet ligjore nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave”.*

Në aktin e vlerësimit profesional të miratuar me vendimin nr. 81, datë 20.06.2016 të KLD-së, për periudhën e vlerësimit 2013-2014, lidhur me treguesit e paanësisë, konkludohet se: *“Inspektorja {...} Osmanaj i kushton rëndësi standardeve etike në përmbushjen e detyrave në gjykata. Nuk ka pasur ankesa ndaj saj për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të paanësisë, përgjatë përmbushjes së funksioneve të inspektores. Përgjithësisht tregohet e kujdesshme ndaj grupeve në nevojë, sidomos në procesin e shqyrtimit të ankesave ndaj gjyqtarëve. Shfaqet e gatshme të presë me korrektesë, sa herë i kërkohet, ankuesit për t'i sqaruar mbi procedurat shqyrtimit të ankesave në Inspektorat. Në këto rrethana ajo duhet të vlerësohet Shumë Mirë për Paanësinë”*.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja e komanduar {...} dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim gjatë procedurës së rivlerësimit kalimtar, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese në përmbajtje të dokumenteve ligjore të hartuara prej saj.

Po ashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese në komunikimin me kolegët, administratën, gjyqtarët apo subjekte të tjera, gjatë ushtrimit të detyrës së inspektores.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga gjyqtarja e komanduar.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se znj. {...} ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin *“Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese”* vlerësohet *“Shumë e lartë”* duke u pikëzuar me 10 pikë.

***3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe vlerësimit profesional të miratuar me vendimin nr. 81, datë 20.06.2016 të KLD-së, për periudhën e vlerësimit.2013-2014 nuk ka të dhëna për numrin e kërkesave të pranuar për përjashtimin e inspektore nga një procedure administrative verifikues apo të dhënat për numrin e kërkesave të bëra nga gjyqtarja e komanduar për të hequr dorë nga përgatitja e dokumenteve ligjore për çështje të caktuara, pavarësisht refuzimit të mëparshëm për të njëjtin shkak.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave të pranuar për përjashtim e saj nga ndonjë procedure administrative verifikues, apo kërkesave për heqje dorë të refuzuara më parë për të njëjtin shkak, pasi këto të dhëna nuk janë kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (*burimet arkivore të KLD/KLGJ*), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar për përjashtimin e inspektore në periudhën e vlerësimit apo kërkesave për heqje dorë të refuzuara.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (*5 dokumentave ligjorë të përzgjedhura me short për vlerësim*) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtim apo heqje dorë nga trajtimi i ankesës apo kryerjes së vlerësimit.

**KONKLUZIONI**

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, pavarësisht funksionit që ai ushtron për kohësisht si i komanduar, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar për përjashtim apo për heqje dorë të refuzuara më parë për të njëjtin shkak, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin dhe aktet e Skemës së Vlerësimit të dala në bazë të këtij ligji, zbatohen për aq sa është e mundur, numri i kërkesave për të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative, për inspektoren {...} është i pakonsiderueshëm.

*Numri i kërkesave të pranuarra për përjashtim/heqje dorë të refuzuara dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuarra për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative” gjyqtarja e komanduar pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet “I pakonsiderueshëm”.*

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### **4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit të komanduar në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### **4.A. Aftësia e komunikimit**

##### **4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Referuar raportit të analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, nuk rezultojnë të jenë analizuar të dhëna të drejtpërdrejta për këtë tregues, por në treguesit lidhur me aftësitë profesionale dhe treguesit lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional, evidentohet aftësia e saj për tu shprehur qartë, thjesht dhe saktë në aktet e shkruara dhe aftësia e saj për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente dhe profesionale në raportet me kolegët, bashkëpunëtorët apo edhe subjektet ankues gjatë pritjes së tyre.

Në aktet e vlerësimit të gjyqtarës të komanduar, nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta për këtë tregues por referuar të dhënave të përshkuara dhe analizuar në treguesit e tjerë të aktit të

vlerësimin, evidentohen aftësitë e saj të larta në drejtim të komunikimit të qartë, korrekt dhe transparent si në aktet e shkruara, ashtu edhe në komunikimin verbal.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar dokumenteve ligjore të hartuara nga gjyqtarja e komanduar, rezulton se ajo është shprehur në mënyrë të qartë, transparente, të saktë, koncize dhe drejtpërdrejtë, duke respektuar normat e shkrimit ligjor.

Nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me mungesën e komunikimit të qartë dhe transparent të saj gjatë ushtrimit të funksionit të inspektores në komunikimin verbal me subjektet me të cilët ka bashkëpunuar apo me të tretët. Përkundrazi evidentohen aftësitë e saj për komunikimin korrekt dhe të drejtpërdrejtë, duke respektuar normat e komunikimit formal gjatë ushtrimit të detyrës.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar ka komunikim të qartë dhe transparent në komunikimin verbal, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj.

***Qartësia dhe transparenca e komunikimit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

### ***4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Referuar raportit të analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe aktit të vlerësimit profesional të gjyqtarës së komanduar, nuk ka të dhëna specifike lidhur me këtë tregues.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar 3 (tre) dokumente ligjore të përzgjedhura për vlerësim dhe akteve të 5 (pesë) çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezultojnë asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve dhe pjesëmarrësve në proces.

Referuar burimeve të tjera të vlerësimit dhe në tërësi akteve të dosjes së vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna të cilat mund të krijojnë dyshim për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve apo pjesëmarrësve në proces, nga ana e gjyqtarës së komanduar.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezultojnë asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja {...} ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të procedimit apo vlerësimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

*Respektimi i konfidencialitetit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

### **4.B. Aftësia për të bashkëpunuar**

#### ***4.B.a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Lidhur me aftësinë për të bashkëpunuar në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, konkludohet se: “Gjatë gjithë punës si inspektore në IKLD nuk ka pasur asnjë vërejtje apo masë disiplinore. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur e gatishmëri dhe produktivitet për punën në grup, si dhe për të krijuar marrëdhënie bashkëpunimi dhe mjedis të përshtatshëm për zbatimin e detyrave. Nuk ka pasur ankesa për punën në grup qoftë për verifikimin e ankesave apo vlerësimeve profesionale të gjyqtarëve”.

Në aktin e vlerësimit të miratuar me vendimin e KLD nr. 81, datë 20.06.2016, për periudhën e vlerësimit 2013-.2014, nuk ka të dhëna specifike në lidhje me këtë tregues por në treguesit e kriterit social dhe angazhimit profesional, theksohet se: *“KLD me vendimin nr.312, datë 18.03.2013 e ka emëruar atë në detyrën e inspektore së Inspektoratit të KLD-së. Gjatë gjithë periudhës së punës së saj si inspektore pranë Inspektoratit të KLD-së nuk ka pasur asnjë vërejtje apo masë disiplinore. Në periudhën e vlerësimit, inspektorja {...} Osmanaj është shfaqur shumë e gatshëm dhe është angazhuar të punojë në grup. Ajo ka marrë pjesë në tre grupe pune: (i) për hartimin e Skemës së Vlerësimeve të Inspektorëve; (ii) për hartimin e programit vjetor të trajnimeve; dhe (iii) për rishikimin e projektit për ndërtimin pallatit të drejtësisë. Ajo ndërton marrëdhënie bashkëpunimi shumë të mira dhe mjedis të përshtatshëm për zbatimin e detyrave. Nuk ka pasur asnjë ankesë për punën e saj në grup, qoftë në kryerjen e vlerësimeve profesionale të gjyqtarëve, qoftë në verifikimin e ankesave. Në këto rrethana, ajo duhet të vlerësohet Shumë Mirë për kriteret sociale”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë (i) raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; (ii) formulari i vetëvlerësimit (iii) mendimi i strukturës përgjegjëse organizative dhe (iv) mendimi i strukturës përgjegjëse administrative. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (*gradimin*), tre nga burimet e vlerësimit si më sipër mungojnë (*përveç formularit të vetëvlerësimit të gjyqtarit të komanduar*) por nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, të analizuara në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe vlerësimin periodik të gjyqtarës së komanduar, rezultojnë të dhëna për të bërë vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi.

Nga të dhënat e analizuara në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe vlerësimin periodik të gjyqtarës {...}, gjatë periudhës së vlerësimit, kohë në të cilën ajo ka qenë e komanduar në detyrën e inspektore, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të saj me kolegët. Referuar të dhënave që rezultojnë nga këto burime evidentohet aftësia e saj e spikatur në drejtim të bashkëpunimit me kolegët, si dhe iniciativa e saj e vazhdueshme për të dhënë kontribut në trajtimin e çështjeve të përbashkëta, me qëllim unifikimin apo përmirësimin e praktikave të punës pranë Inspektoratit të KLD-së.

Sa më sipër, në mungesë të të dhënave, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, për mungesën e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me kolegët, si dhe duke analizuar të dhënat burimore që tregojnë aftësi të larta të saj në këtë drejtim, rezulton e qartë se ky bashkëpunim ka ekzistuar dhe ka qenë në nivel të lartë.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues niveli i komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës së komanduar me kolegët ka qenë shumë e lartë dhe duke u pikëzuar në nivel maksimal.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### **4.B.b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Referuar raportit të analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, nuk rezultojnë të jenë analizuar të dhëna të drejtpërdrejta për këtë tregues, por në treguesit lidhur me aftësitë organizative evidentohet kontributi i gjyqtarës së komanduar për pjesëmarrje në grupe pune dhe përfaqësimin gjyqësor të KLD, duke u evidentuar në këtë akt si vijon “*Në pasqyrimin e këtij treguesi duhet mbajtur në konsideratë volumi shumë i madh i punës që ka përballuar Inspektorja {...} Osmanaj si në seksionin e vlerësimit etiko profesional edhe në atë të trajtimit të ankesave, në përfaqësimet e KLD në gjykatë, si dhe në pjesëmarrjen e saj në grupe të punës të ngritura nga KLD..*”. Ndërsa në aktin e vlerësimit të miratuar me vendimin e KLD nr. 81, datë 20.06.2016, për periudhën e vlerësimit 2013-.2014, evidentohet si vijon “*....Ajo ka marrë pjesë në tre grupe pune: (i) për hartimin e Skemës së Vlerësimeve të Inspektorëve; (ii) për hartimin e programit vjetor të trajnimeve; dhe (iii) për rishikimin e projektit për ndërtimin pallatit të drejtësisë...*”.

### **Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:**

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë (i) raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; (ii) formulari i vetëvlerësimit (iii) mendimi i strukturës përgjegjëse organizative dhe (iv) mendimi i strukturës përgjegjëse administrative. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e



nivelit të vlerësimit (gradimin), tre nga burimet e vlerësimit si më sipër mungojnë (*përveç formularit të vetëvlerësimit të gjyqtarit të komanduar*) por nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, të analizuara në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe vlerësimin periodik të gjyqtarës së komanduar, rezultojnë të dhëna për të bërë vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi.

Nga të dhënat e analizuara në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe në aktin e vlerësimit të miratuar me vendimin e KLD nr. 81, datë 20.06.2016, për periudhën e vlerësimit 2013-2014, rezulton angazhimi i inspektore {...} në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga strukturat drejtuese të KLD-së sikurse janë (i) pjesëmarrjen në grupin e punës për hartimin e Skemës së Vlerësimit të punës së inspektorit; (ii) pjesëmarrje në grup pune për hartimin e programit vjetor të trajnimeve (iii) pjesëmarrje në grup pune për rishikimin e projektit për ndërtimin pallatit të drejtësisë (iv) pjesëmarrje në grupin e punës European Network of Councils for the Judiciary (ENCJ) për hartimin e “Manual i Standardeve Gjyqësore Minimale në Procedimet Disiplinore të Gjyqtarëve”, ku gjyqtarja ka kontribuar në pjesën e manualit që i përket Shqipërisë<sup>29</sup>(v) përfaqësimi në gjykatë.

## KONKLUZIONI

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë një deri dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve të komanduar, për të cilët nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi përfshirjen në përgatitjen e produkteve. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e gjyqtarës së komanduar në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga strukturat drejtuese të Këshillit, aftësia e saj në lidhje me këtë tregues pikëzohet maksimalisht, duke u pikëzuar me 5 pikë.

*Gatishmëria dhe kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në treguesin “Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit” vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë*

### ***4.B.c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

---

<sup>29</sup>Lidhur me këtë angazhim gjyqtarja me shkresën e datës 20.10.2022, protokolluar në Këshilli me nr.5565 prot., datë 24.10.2022 ka depozituar kopje të Manualit Standardet Minimale Gjyqësore V (Minimum Judicial Standards V) - ENCJ Report 2014-2015

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Lidhur me këtë aspekt, në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, konkludohet se: “...Ajo karakterizohet nga respekti që gëzon tek kolegët e punës, është e hapur për të diskutuar dhe zgjidhur çështje brenda strukturës që zbatohen për herë të parë në funksion të praktikave të mira...”.

Në aktin e vlerësimit të aftësive profesionale të miratuar me vendimin e KLD-së nr.81, datë 20.06.2016, për periudhën e vlerësimit 2013-2014, lidhur me këtë tregues (në treguesin “Etika dhe disiplina në punë”), konkludohet se: “Inspektorja {...} Osmanaj ka mbajtur komunikim tepër korrekt me eprorët dhe kolegët. Është e urtë, e sinqertë dhe e dëgjueshme, respekton kolegët dhe respektohet prej tyre. Është e hapur për të diskutuar mbi çështje të punës, duke dëgjuar dhe reflektuar për ndryshimet eventuale në funksion të harmonizimit të praktikave të punës. Ka aftësi komunikuese edhe në procesin e pritjes së ankesave me qytetarët...”

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë (i) raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar; (ii) formulari i vetëvlerësimit (iii) mendimi i strukturës përgjegjëse organizative dhe (iv) mendimi i strukturës përgjegjëse administrative. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), tre nga burimet e vlerësimit si më sipër mungojnë (përveç formularit të vetëvlerësimit të gjyqtarit të komanduar) por nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, të analizuara në raportin e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe vlerësimin periodik të gjyqtarës së komanduar, rezultojnë të dhëna për të bërë vlerësimin dhe pikëzimin e këtij treguesi.

Referuar aktit të vlerësimit të aftësive profesionale, rezulton se aftësia e gjyqtarës së komanduar {...} për të krijuar marrëdhënie korrekte me eprorët dhe kolegët, si dhe aftësia e saj për të shmangur situata konfliktuale është vlerësuar “shumë mirë”.

Referuar burimeve të vlerësimit dhe tërësisë së akteve të dosjes së vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për ekzistencën e situatave të konfliktit apo mënyrës së menaxhimit të tyre, raste të shfaqjes së problemeve apo vështirësive gjatë punës dhe reagimi i saj për zgjidhjen e tyre me efikasitet dhe duke ruajtur qetësinë dhe etikën.

Në kushtet kur nuk ka të dhëna konkrete që mund të cenojnë vlerësimin për aftësinë e gjyqtarës së komanduar për të bashkëpunuar dhe reaguar me efikasitet në rast nevoje dhe në të njëjtën kohë, shkalla e bashkëpunimit dhe ndërveprimit të saj me eprorët dhe kolegët është vlerësuar maksimalisht nga ish/KLD, aftësia e saj për këtë tregues është shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

## **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues shkalla e bashkëpunimit dhe aftësia për të reaguar me efikasitet në rast nevoje për gjyqtaren e komanduar {...} është shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevoje” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### **4.C Gatishmëria për t’u angazhuar në veprimtari të tjera**

#### ***4.C.a Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të shkollës së magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarës;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

#### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar raportit e analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe akteve të dosjes së rivlerësimit, sikurse është pasqyruar në burimet e vlerësimit në pjesën e parë të këtij akti, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit, ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) në cilësinë e lehtësueses në Programin e Formimit Vazhdues në 3 (tre) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 4 ditë trajnimi;

- (ii) në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 6 (gjashtë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 8 ditë trajnimi, ose referuar Rregullores së Shkollës së Magjistraturës vlerësohet si pjesëmarrje e konvertuar në 16 ditë trajnimi;<sup>30</sup>
- (iii) në cilësinë e pjesëmarrëses në aktivitete trajnuese jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në 6 (gjashtë) aktivitete trajnuese të zhvilluara gjatë periudhës së vlerësimit, gjithsej 11 ditë trajnimi.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, ligji nr. 9877, datë 18.02.2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese apo kohëzgjatjen minimale të këtij angazhimi. Ndërkohë, ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr.8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve*.

Aktualisht, në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti, si dhe gjatë pesë viteve.<sup>31</sup> Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij, të organizuara

---

<sup>30</sup>Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se: “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare”.

<sup>31</sup> Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se : “1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuar nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit”.

edhe nga institucione të tjera trajnimi, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij, që tregojnë ngritjen profesionale. Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit e miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 "Për Shkollën e Magjistraturës", i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrjeje.

Sa më sipër, rezulton se znj. {...}, ka marrë pjesë në 15 (pesëmbëdhjetë) aktivitete të formimit profesional të llojit trajnime dhe seminare, brenda dhe jashtë programit të Formimit Vazhdues, të cilat kanë zgjatur në **total 31 ditë**.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarës në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë 20 pikë, meqenëse për periudhën 3 vjeçare rezulton pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 20 ditë trajnimi dhe pjesëmarrja në saj në aktivitet trajnues jashtë këtij programi, zhvilluar në 11 ditë trajnimi. Kjo, pasi legjislativi i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal pjesëmarrjeje në aktivitete trajnuese, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

## **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë në konsideratë frekuencën e angazhimit të gjyqtarës në aktivitetet trajnuese, sipas të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, gjyqtarja pikëzohet me 20 pikë.

***Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës së komanduar në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale pikëzohet me 20 pikë.

#### **4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarës;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

#### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar raportit të analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton se znj. {...} është angazhuar në cilësinë e lehtësueses në 3 (tre) aktivitetet trajnuese me tema:

- *“Birësimi i fëmijëve dhe problematikat e praktikës gjyqësore në proceset e birësimit, Instituti i amësisë dhe atësisë në këndvështrimin e praktikës tonë gjyqësore shqiptare dhe të GJEDNJ-së”,* aktivitet i zhvilluar në datat 26-27 maj 2015;
- *“Vlerësimi profesional dhe etik i gjyqtarëve (të dhëna bazë mbi procedurën dhe kriteret, si dhe përqasja me standardet dhe praktikën e mira evropiane)”*, aktivitet i zhvilluar në datën 23 maj 2016;
- *“Procedimi disiplinor i gjyqtarëve (të dhëna bazë mbi procedure dhe kriteret, si dhe përqasja me praktikën e mira evropiane)”*, aktivitet i zhvilluar në datën 30 maj 2016.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe një deri dy pikë të tjera iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren e komanduar {...}, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses në 3 (tre) aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja e komanduar të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese.

*Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja e komanduar vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.*

### **4.C.c Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, gjyqtari gjatë periudhës që është i komanduar në Këshill, mund të angazhohet dhe të bëjë përpjekje për të përmirësuar sistemin e drejtësisë në mënyra të ndryshme, në angazhime të tjera që nuk lidhen me pozicionin e tij të punës në Këshill apo me detyra të ngarkuara nga strukturat drejtuese të Këshillit. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike. Pjesëmarrja në këto veprimtari duhet të respektojë jo vetëm kuadrin ligjor, por edhe rregullat përkatëse të etikës të miratuara nga Këshilli për këtë qëllim.

Referuar të analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se znj. {...}, në periudhën e vlerësimit që përfshin vitet e plota 2013-2016, ka marrë pjesë në

disa angazhime, të cilat vlerësohen si veprimtari ndërinstitucionale me qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë, si më poshtë:

- (i) Pjesëmarrje në takimet e Këshillit Drejtues për të lehtësuar zbatimin e projektit “Mbështetje për efikasitetin e drejtësisë SEJ”, financuar nga BE dhe KE, me fokus përzgjedhjen e 10 gjykatave pilot, konsultimi mbi termat e referencës, konsultimi mbi sondazhet dhe mbi miratimin e raporteve të ekspertëve të projektit;<sup>32</sup>
- (ii) Pjesëmarrje në takimet e misionit TAIEX lidhur me bashkëpunimin me ILDKPKI në luftën kundër korrupsionit, pjesë e detyrimeve që burojnë nga Dokumenti i Udhërrëfyesit të pesë prioritetëve për marrjen e statusit të vendit kandidati, të mbajtura në datat 17-18 qershor 2014.<sup>33</sup>

Gjithashtu, rezulton se në vitet akademike 2013-2014 dhe 2014-2015 gjyqtarja {...} Osmanaj është angazhuar si pedagoge e jashtëm në Departamentin e Drejtësisë në Shkollën e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër), referuar vërtetimit nr.15/3 prot., datë 15.02.2016. Po kështu, edhe për vitin akademik 2015-2016 gjyqtarja {...} Osmanaj është angazhuar si pedagoge e jashtëm në Departamentin e të Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë të UT, referuar vërtetimit, datë 10.10.2016, të Fakultetit të Drejtësisë.

Angazhim tjetër i gjyqtarës në kuadër të veprimtarive të tjera ndërinstitucionale konsiderohet edhe angazhimi i saj si eksperte në projektin “Edukimi Ligjor i Rinisë” (Legal Education of Youth), të zhvilluar në datat 25-26 shkurt 2016 dhe 28-29 prill 2016, financuar nga Ambasada Gjermane, ku gjyqtarja rezulton të ketë dhënë kontributin e saj në përgatitjen e manualit të botuar nga Qendra L.I.S.T (Legal Information and Study Team -Ekipi për studim dhe informim ligjor), referuar vërtetimit të lëshuar nga kjo qendër me nr.13/2016 datë 05.10.2016.

Angazhimet e mësipërme të gjyqtarës për shkak të natyrës së tyre nuk lidhen me pozicionin e punës si gjyqtare e komanduar dhe as përbëjnë detyra të caktuara nga organet drejtuese të ish/KLD-së, pavarësisht se përzgjedhja për angazhim në veprimtari ndërinstitucionale është bërë nga institucioni ku gjyqtarja ka qenë e komanduar. Duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe nga një ose dy pikë të tjera do t’iu shtohen në vlerësim në rast se këto veprimtari kryhen jashtë veprimtarisë së tyre si të komanduar në Këshill, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 5 pikë duke qenë se rezultoi angazhimi i saj në veprimtari të kësaj natyre.

## KONKLuzioni

---

<sup>32</sup>Të dhënat e pasqyruara në formularin e vetëvlerësimit profesional mbështeten me shkresën nr. 346 prot., datë 24.01.2017 të KLD-së;

<sup>33</sup>Bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit janë paraqitur komunikimet me email nëpërmjet të cilëve provohet pjesëmarrja dhe kontributi i gjyqtarës së komanduar



Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera të kësaj natyre.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, për treguesin “Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, duke qenë se rezulton angazhimi i saj në disa aktivitete të kësaj natyre.*

#### **4.C.ç Publikimet ligjore akademike**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;
- Aktet e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit të komanduar në detyrën e inspektorit, të miratuar nga ish/Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht vendimi nr.81, datë 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares;
- Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar raportit të analizimit të aftësive profesionale të rivlerësimit, në treguesit lidhur me angazhimi profesional evidentohet se “... ka botuar libra me karakter juridik etj. (të dhëna më të plota të cituara në pjesën e parë të këtij raporti vlerësues)”.

Në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nga aktet e dorëzuara nga gjyqtarja bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit profesional, evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka qenë bashkëautore në botimin “Edukimi ligjor dhe qytetar”, i botuar nga Qendra “Ekipi për Informim dhe Studim Ligjor”, në vitin 2016. Por ky botim është një “Udhëzues për mësuesit e lëndës së qytetarisë”, nuk është realizuar në revistë shkencore me bord editorial i pajisur me numra identifikimi ISBN, ISSN, e si i tillë nuk përbën publikim ligjor akademik që kontribuon për zhvillimin e doktrinës, por i shërben edukimit ligjor të komunitetit që është vlerësuar në treguesin 4.C.c.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtaren {...} (Osmanaj) ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për rrjedhojë, ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

*Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë të dhëna dhe për këtë ky tregues pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

---

### NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

---

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësia profesionale	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësia organizative	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësia personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	395	Shkëlqyeshëm

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT  
TË GJYQTARES SË KOMANDUAR {...} (OSMANAJ)  
GJATË USHTRIMIT TË DETYRËS SË INSPEKTORES  
PRANË INSPEKTORATIT TË ISH/KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

1. AFTËSIA PROFESIONALE			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar; 2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”; 3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.	Shumë e lartë	25 pikë	<b>Shkalla e aftësisë :</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin	1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të	Shumë e lartë	25 pikë	<b>Shkalla e aftësisë :</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë

		<p>rivlerësimin kalimtar;</p> <p>2.Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimin kalimtar.</p>			<p>Mbi mesataren – 20 pikë</p> <p>Shumë e lartë – 25 pikë</p>
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria	<p>1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimin kalimtar;</p> <p>2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimin kalimtar.</p>	Shumë e lartë	15 pikë	<p><b>Shkalla e aftësisë :</b></p> <p>E dobët – 3 pikë</p> <p>Nën mesataren – 6 pikë</p> <p>Mesatare – 9 pikë</p> <p>Mbi mesataren – 12 pikë</p> <p>Shumë e lartë – 15 pikë</p>
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumenteve ligjorë	<p>1.Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimin kalimtar;</p> <p>2.Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë</p>	Shumë e lartë	10 pikë	<p><b>Shkalla e aftësisë:</b></p> <p>E dobët – 2 pikë</p> <p>Nën mesataren – 4 pikë</p> <p>Mesatare – 6 pikë</p> <p>Mbi mesataren – 8 pikë</p> <p>Shumë e lartë – 10 pikë</p>

		mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”; 3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.			
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar; 2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”; 3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.	Shumë e lartë	25 pikë	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>2. AFTËSIA ORGANIZATIVE</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Aftësia për të realizuar volumin normal të punës	1. Të dhënat statistikore të pozicionit të punës si inspektor; 2. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të	Shumë e lartë	25 pikë	<b>Shkalla e aftësisë:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë

		<p>procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>3. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>4. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.</p>			Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të respektuar afatet	<p>1. Të dhënat statistikore të pozicionit të punës si inspektor;</p> <p>2. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>3. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>4. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.</p>	Shumë e lartë	25 pikë	<p><b>Shkalla e aftësisë:</b></p> <p>E dobët – 5 pikë</p> <p>Nën mesataren – 10 pikë</p> <p>Mesatare – 15 pikë</p> <p>Mbi mesataren – 20 pikë</p> <p>Shumë e lartë – 25 pikë</p>
<b>B. Efektiviteti dhe metodologjia</b>	a. Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës	<p>1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i</p>	Shumë e lartë	25 pikë	<p><b>Shkalla e aftësisë:</b></p> <p>E dobët – 5 pikë</p> <p>Nën mesataren – 10 pikë</p> <p>Mesatare – 15 pikë</p> <p>Mbi mesataren – 20 pikë</p> <p>Shumë e lartë – 25 pikë</p>

		ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”; 3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.			
<b>C. Rregullshmëria dhe saktësia</b>	a. Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit	1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar; 2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”; 3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.	Shumë e lartë	10 pikë	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë

	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit	<p>1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.</p>	Shumë e lartë	15 pikë	<p><b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b>  E dobët- 3 pikë  Nën mesataren – 6 pikë  Mesatare – 9 pikë  Mbi mesataren – 12 pikë  Shumë e lartë - 15 pikë</p>
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<p>1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3. Të dhëna nga burimet arkivore të</p>	Shumë e lartë	35 pikë	<p><b>Shkalla e aftësisë:</b>  E dobët- 7 pikë  Nën mesataren – 14 pikë  Mesatare – 21 pikë  Mbi mesataren – 28 pikë  Shumë e lartë – 35 pikë</p>



		<p>Këshillit/KLD-së;</p> <p>4.Të dhënat për masa disiplinore;</p> <p>5.Rezultatet e verifikimit të ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit.</p>			
<b>B. Integriteti i gjyqtarit të komanduar</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<p>1.Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>2.Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3.Të dhëna nga burimet arkivore të Këshillit/KLD-së;</p> <p>4.Të dhënat për masa disiplinore;</p> <p>5.Rezultatet e verifikimit të ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit.</p>	Shumë e lartë	40 pikë	<b>Shkalla e integritetit:</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
<b>C. Paanësia e gjyqtarit të komanduar</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<p>1.Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>2.Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi</p>	Shumë e lartë	10 pikë	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë

		vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”; 3.Dokumentet ligjorë të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.			
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative	1.Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar; 2.Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”; 3.Dokumentet ligjorë të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.	I pa konsiderueshëm	15 pikë	<b>Numri i kërkesave:</b> Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>95</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;	Shumë e lartë	25 pikë	<b>Qartësia dhe transparencja e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë

		<p>2.Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.</p>			<p>Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë</p>
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<p>1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>2.Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.</p>	I lartë	15 pikë	<p><b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë</p>
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale	<p>1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>2.Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë</p>	Shumë e lartë	10 pikë	<p><b>Shkalla e aftësisë:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë</p>

		të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”; 3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.			
	b. Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit	1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar; 2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”; 3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.	Ka të dhëna	5 pikë	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 4 deri 5 pikë
	c. Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë	1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar; 2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”; 3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të	Shumë e lartë	10 pikë	<b>Shkalla e aftësisë:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë

		rivlerësimin kalimtar.			
C. <b>Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<p>1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimin kalimtar;</p> <p>2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3. Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimin kalimtar;</p> <p>4. Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;</p> <p>5. Të dhënat nga dosja personale e gjyqtarit;</p> <p>6. Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimin.</p>	15-120 ditë	20 pikë	<p><b>Pjesëmarrja e gjyqtarit:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë &lt;15 ose &gt; 120 ditë: 4</p> <p>(periudha 5/vjeçare) 30-200 ditë – 20 pikë &lt;30 ose &gt; 200 ditë: 4</p>
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve	<p>1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimin kalimtar;</p> <p>2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i</p>	Ka të dhëna	5 pikë	<p>Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 4 deri 5 pikë</p>

		<p>ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3. Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;</p> <p>4. Të dhënat nga dosja personale e gjyqtarit;</p> <p>5. Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.</p>			
	c. Pjesëmarrja në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë	<p>1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>2. Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektore {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3. Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;</p> <p>4. Të dhënat nga dosja personale e gjyqtarit;</p> <p>5. Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.</p>	Ka të dhëna	5 pikë	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 4 deri 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	<p>1. Konkluzionet e arritura në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga Këshilli i</p>	Nuk ka të dhëna	0 pikë	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë

	<p>Lartë Gjyqësor, për qëllime të procesit të rivlerësimit kalimtar;</p> <p>2.Vendim Nr.81, dt. 20.06.2016 i ish/Këshillit të Lartë të Drejtësisë Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të inspektores {...} Osmanaj për periudhën 2013-2014”;</p> <p>3. Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;</p> <p>4. Të dhënat nga dosja personale e gjyqtarit;</p> <p>5. Të dhëna nga burimet e tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit.</p>			
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>		<b>395 pikë</b>		
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>		<b>Shkëlqyeshëm</b>		

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**